



2022

Raporti Vjetor i Përmbledhur

*Performanca e Kontratave të Koncesionit dhe të Partneritetit
Publik Privat*



Ky raport përfshin ecurinë dhe performancën financiare dhe jofinanciare të Kontratave të Koncesionit dhe Partneritetit Publik Privat në Republikën e Shqipërisë mbështetur në raportimet dhe informacionin e përcjellë nga Autoritetet Kontraktuese për vitin 2022.

Ministria e Financave

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr.3, Tiranë, 1000, Shqipëri

Hyrje	8
1. Trendi i projekteve të koncesioneve dhe partneritetit publik privat në Shqipëri.	8
Figura nr. 1: Trendi i projekteve me Koncesioneve/PPP të nënshkruara ndër vite, 2004-2022.....	9
Figura nr. 2: Projekte Koncesion/PPP të kërkuara dhe të pakërkuara (%)	9
Figura nr. 3: Numri total i kontratave koncesionare/PPP të miratuara për periudhat 2004-2013 dhe 2014-2022	10
Figura nr. 4: Numri i kontratave Koncesionare/PPP sipas Autoritetit Kontraktues që ka nënshkruar kontratën në total.....	10
Figura nr. 5: Numri dhe vlera totale e investimit (në Lekë) të projekteve Koncesionare/PPP aktive sipas sektorëve, 2022	11
Tabela 6: Përqindja e pagesave buxhetore ndaj totalit të të ardhurave tatimore të vitit paraardhës buxhetor	12
Figura nr. 7: Pagesat buxhetore për kontratat me mbështetje buxhetore.....	12
2. Prezantim i ecurisë së Kontratave Koncesionare/PPP në Shqipëri	13
Sektori i Transportit.....	13
1. Kontrata Koncesionare/PPP “Për ndërtimin, përmirësimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e autostradës Milot-Morinë”	13
Tabela 1: Pagesat buxhetore për projektin objekt kontrate “Milot-Morinë”	14
2. Kontrata Koncesionare/PPP “Për ndërtimin, përmirësimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e Rrugës së Arbrit”	14
3. Kontrata e koncesionit/PPP “Për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e segmentit rrugor “Milot Balldren”	15
4. Kontrata e koncesionit/PPP “Për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugës “Porti i Jahteve- By Pass Orikum Dukat (Ura e Shën Elizës)”	16
5. Kontrata Koncesionare/PPP “Ndërtimi, vënia në punë, operimi dhe mirëmbajtja e Aeroportit ‘Nënë Tereza’	17
6. Kontratë Koncesioni /PPP “Për rehabilitimin, operimin, transferimin e aeroportit të Kukësit”	18
7. Kontratë Koncesioni/PPP “Për Menaxhimin, Operimin dhe Mirëmbajtjen e Terminalit të trageteve të Portit të Durrësit”	18
Sektori i Mjedisit.....	19
9. Kontrata Koncesionare/PPP “Për Ndërtim Landfilli, Inceneratori dhe Rehabilitim i Venddepozitimeve Ekzistuese Tiranë dhe Prodhimin e Energjisë Elektrike”	20
10. Kontrata Koncesionare/PPP “Për Ndërtimin e Administrimin e Impjantit të Trajtimit të Mbetjeve Urbane të Qarkut Fier dhe Prodhimin e Energjisë”	21
11. Kontrata Koncesionare/PPP “Për Ndërtimin dhe Administrimin e Impjantit të Përpunimit të Mbetjeve Urbane të Qarkut të Elbasanit”	22
12. Kontrata Koncesionare/PPP “Për dhënien me koncesion/PPP të shërbimit të pastrimit, grumbullimit, transportimit, dhe seleksionimit të mbetjeve urbane të Bashkisë Kamëz”	22
13. Kontratë Koncesioni/PPP “Menaxhimi dhe zhvillimi teknologjik i prodhimit të fidanëve pyjor/arrorë në fidanishten shtetërore të Cërrikut Elbasan”	23
14. Kontratë Koncesioni/PPP “Për shfrytëzimin e burimit ujqor Sasaj, Bunec”	24
Sektori i Shëndetësisë	24

15. Kontratë Koncesioni/PPP “Për shërbime të integruara për ofrimin e setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale, furnizimin me material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, si dhe trajtimin e mbejeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale”	24
16. Kontrata Koncesionare/PPP “Për paketën e shërbimeve të kontrollit mjekësor bazë për grupmoshat 35-70” 25	
17. Kontratë Koncesioni/PPP “Për ofrimin e shërbimit të hemodializës”	27
18. Kontratë Koncesioni/PPP “Për ofrimin e shërbimeve laboratorike mjekësore”	28
Sektori i Energjitikës.....	29
19. Kontrata Koncesionare/PPP “Për projektimin, financimin, ndërtimin, pronësinë, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Hidrocentralit Ashta	29
20. Kontrata Koncesionare/PPP “Për projektimin financimin, ndërtimin, marrjen në pronësi, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e projektit të hidrocentralit në lumin Devoll”	30
21. Kontratë koncesioni/PPP “Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentraleve Prellë 1 dhe Prellë 2”	31
22. Kontratë koncesioni/PPP “Ndërtim, shfrytëzim dhe transferim të Hidrocentraleve Lura 1, 2 dhe 3”	32
23. Kontratë Koncesioni/PPP “Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Bistrica 3 dhe 4”	32
24. Kontratë Koncesioni/PPP “Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Ballenjë”	33
25. Kontratë Koncesioni/PPP “Kontratë për ndërtimin, shfrytëzimin dhe transferimin e hidrocentralit Bishnica 1,2” 34	
26. Kontratë Koncesioni/PPP “Kontratë për ndërtimin,shfrytëzimin dhe transferimin e hidrocentraleve Çekrezë 1 dhe Çekrezë 2”	34
27. Kontratë Koncesioni/PPP “Ndërtimi, operimi, mirëmbajtja dhe transferimi i hidrocentraleve të kaskadës së lumit Dardhë”	35
29. Kontratë Koncesioni/PPP “Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Dobrenje-Tomorrice, në Përroin e Hijes, Skrapar”	36
30. Kontratë Koncesioni/PPP “Ndërtimi, operimi dhe transferimi i hidrocentralit Fterre dhe Fterre 1”	37
31. Kontratë Koncesioni/PPP “Kontratë për ndërtimin,shfrytëzimin dhe transferimin e hidrocentralit Hurdhas 1, 2, 3”	38
32. Kontratë Koncesioni/PPP “Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Gavran dhe Gavran 1”	38
33. Kontratë koncesioni/PPP “Ndërtimi, operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Kacni”	39
34. Kontratë Koncesioni/PPP “Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Gojan, Gjogjan, Peshqesh, Ura e Fanit, Fangu”	40
35. Kontratë Koncesioni/PPP “Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Kasollet e Selcës”	40
36. Kontratë Koncesioni/PPP “Ndërtimi, operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Kryezi dhe Kryezi i Epërm” 41	
37. Kontratë Koncesioni/PPP “Ndërtimi i hidrocentralit, operim dhe transferim i hidrocentralit Lengarica 1 dhe 2”	42
38. Kontratë Koncesioni/PPP “Ndërtimi, operimi, mirëmbajtja dhe transferimi i hidrocentraleve Murdhar 1 dhe Murdhar 2”	42
39. Kontratë Koncesioni/PPP “Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Rapun 1, Rapun 2”	43
40. Kontratë Koncesioni/PPP “Ndërtimi, operimi dhe transferimi i hidrocentraleve Rapun 3, Rapun 3A dhe Rapun 4”	44
41. Kontratë Koncesioni/PPP “Ndërtimi, operimi dhe transferimi i hidrocentraleve Sotirë, Sotirë 2”	44
42. Kontratë Koncesioni/PPP “Ndërtimi, operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Përroi i Trebishit, Bulqizë” 45	
43. Kontratë Koncesioni/PPP “Ndërtimi, operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Vërtop”	46

44. Kontratë Koncesioni/PPP “Ndërtimi, operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Vlushë”	46
45. Kontratë Koncesioni/PPP “Ndërtimi, operimi dhe transferimi i hidrocentralit Truen”	47
46. Kontratë Koncesioni/PPP “Ndërtimi, operimi dhe transferimi i hidrocentralit Steblevë”	48
47. Kontratë Koncesioni/PPP “Ndërtimi, operimi dhe transferimi i hidrocentralit Shpella Poshtë II dhe Shpella Poshtë III”	48
48. Kontratë Koncesioni/PPP “Ndërtimi, operimi dhe transferimi i hidrocentralit Lumi Zalli i Okshtunit”	49
49. Kontratë Koncesioni/PPP “Ndërtimi, operimi dhe transferimi i hidrocentralit Lumi i Treskës”	50
50. Kontratë Koncesioni/PPP “Ndërtimi, operimi dhe transferimi i hidrocentralit Gostivisht, Langarica 3, Ura e Dashit”	50
51. Kontratë Koncesioni/PPP “Ndërtimi, operimi dhe transferimi i hidrocentralit Shemri dhe Mgullë”	51
52. Kontratë Koncesioni/PPP “Ndërtimi, operimi dhe transferimi i hidrocentralit Sllabinjë”	52
54. Kontratë Koncesioni/PPP “Ndërtimi, operimi dhe transferimi i hidrocentralit Tervol”	53
55. Kontratë Koncesioni/PPP “Ndërtimi, operimi dhe transferitmi i hidrocentralit Faqekuq 1 dhe 2”	54
56. Kontratë Koncesioni/PPP “Ndërtimi, operimi dhe transferitmi i hidrocentralit Dishnicë”	54
58. Kontratë Koncesioni/PPP “Ndërtimi, operimi dhe transferitmi i hidrocentralit Çarshovë”	56
59. Kontratë Koncesioni/PPP “Ndërtimi, operimi dhe transferitmi i hidrocentralit Bogovë”	56
60. Kontratë Koncesioni/PPP “Rehabilitimi, shfrytezimi dhe transferimi i hidrocentralit Lenie, Çorovodë”	57
61. Kontratë Koncesioni/PPP “Kontratën e Koncesionit, për ndërtimin e hidrocentralit "Sasaj”	58
62. Kontratë Koncesioni/PPP “Rehabilitim, shfrytëzim dhe transferim të hidrocentralit “Smokthinë”	58
63. Kontratë Koncesioni/PPP “Për ndërtimin e hidrocentraleve "Stranik, Zall Tore”	59
64. Kontratë Koncesioni/PPP “Për ndërtimin e hidrocentraleve Ternovë dhe Zall Bulqizë”	60
65. Kontratë Koncesioni/PPP “Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Malla ”	60
66. Kontratë Koncesioni/PPP “Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Blaç ”	61
67. Kontratë Koncesioni/PPP “Ndërtim, operim dhe transferim Hec Holta Kabash dhe Holta Porocan ”	62
68. Kontratë Koncesioni/PPP “Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Backa 1, Backa 2, Backa A, Backa B, Backa C ”	62
69. Kontratë Koncesioni/PPP “Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Lumzi ”	63
70. Kontratë Koncesioni/PPP “Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Vendresh, në Pellgun ujëmbledhës Përroi Vendreshes, Komuna Vendresh, Rrethi Skrapar ”	64
71. Kontratë Koncesioni/PPP “Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Shengjon, Komuna Fan, Rrethi Mirditë ”	64
72. Kontratë Koncesioni/PPP “Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Skatinë”	65
73. Kontratë Koncesioni/PPP “Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentralit Tuçep 2”	66
74. Kontratë Koncesioni/PPP “Ndërtimin, operimin dhe transferimin e Hidrocentraleve, Cemerica 1, Cemerica 2 dhe Cemerica 3”	66
75. Kontratë Koncesioni/PPP “Ndërtimin, operimin dhe transferimin e hidrocentralit Qytezë”	67
76. Kontratë Koncesioni/PPP “Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentraleve mbi Lumin Seta”	68
77. Kontratë Koncesioni/PPP “Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentraleve Germani 1, 2, 3, 4 ”	68
79. Kontratë Koncesioni/PPP “Ndërtim, operim dhe transferim i hidrocentraleve Gur Shpat1, Gur Shpat 2”	70
80. Kontratë Koncesioni/PPP “Ndërtim, operim dhe transferim i hidrocentralit Mollaj”	70
81. Kontratë Koncesioni/PPP “Ndërtim, operim dhe transferim i hidrocentralit Lapaj”	71
82. Kontratë Koncesioni/PPP “Ndërtim, operim, mirëmbajtje dhe transferim i hidrocentralit Lena 1, Lena 2, Lena 2-A”	72

83. Kontratë Koncesioni/PPP “Ndërtim, operim, mirëmbajtje dhe transferim i hidrocentraleve Lenie, Shalës, Strelcë”	72
84. Kontratë Koncesioni/PPP “Ndërtim, operim, mirëmbajtje dhe transferim i hidrocentralit Picar 1”	73
85. Kontratë Koncesioni/PPP “Ndërtim, operim, mirëmbajtje dhe transferim i hidrocentralit Qafëzezë ”	74
86. Kontratë Koncesioni/PPP “Ndërtim, operim, mirëmbajtje dhe transferim i hidrocentralit Verbë - Selcë” ..	74
87. Kontratë Koncesioni/PPP “Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Nishova 1, 2”	75
88. Kontratë Koncesioni/PPP “Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Radovë”	76
89. Kontratë Koncesioni/PPP “Ndërtim, operim dhe mirëmbajtje e hidrocentralit Shutinë”	76
90. Kontratë Koncesioni/PPP “Ndërtim, operim dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Strelca 1, Strelca 2, Strelca 3” ..	77
91. Kontratë Koncesioni/PPP “Ndërtim, operim dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Nicë”	78
92. Kontratë Koncesioni/PPP “Ndërtim, operim dhe mirëmbajtje e hidrocentraleve Shtika 1,2,3,4”	78
93. Kontratë Koncesioni/PPP “Ndërtim, operim dhe mirëmbajtje e hidrocentralit Koxheraj”	79
94. Kontratë Koncesioni/PPP “Ndërtim, operim dhe mirëmbajtje e hidrocentralit Perrollaj”	80
95. Kontratë Koncesioni/PPP “Ndërtim, operim dhe mirëmbajtje e hidrocentralit Driza”	80
96. Kontratë Koncesioni/PPP “Ndërtim, operim dhe mirëmbajtje e hidrocentralit Qarr Kaltanj”	81
97. Kontratë Koncesioni/PPP “Ndërtim, operim dhe mirëmbajtje e hidrocentraleve Kozel, Helmes 1 dhe Helmes 2”	82
98. Kontratë Koncesioni/PPP “Ndërtim, operim dhe mirëmbajtje e hidrocentralit Ujanik 2”	82
99. Kontratë Koncesioni/PPP “Ndërtim, operim dhe mirëmbajtje e hidrocentralit Bisak”	83
100. Kontratë Koncesioni/PPP “Ndërtim, operim dhe mirëmbajtje e hidrocentralit Ostren i Vogël 2”	84
101. Kontratë Koncesioni/PPP “Ndërtim, operim dhe mirëmbajtje e hidrocentralit Martanesh”	84
102. Kontratë Koncesioni/PPP “Ndërtim, operim dhe mirëmbajtje e hidrocentraleve Borje, Oreshkë, Cernalevë, Cernalevë 1”	85
103. Kontratë Koncesioni/PPP “Ndërtim, operim dhe mirëmbajtje e hidrocentraleve Orgjost i Ri, Bele 1, 2, Topojan 1,2”	86
104. Kontratë Koncesioni/PPP “Ndërtim, operim dhe mirëmbajtje e Hidrocentralit "Labinot-Mal"	86
105. Kontratë Koncesioni/PPP “Ndërtim, operim dhe mirëmbajtje e hidrocentralit Selishtë”	87
Sektori i Kontrollit Fiskal	88
107. Kontratë Koncesioni/PPP “Për shërbimin e kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm”	89
108. Kontrata e Koncesionit/PPP “Për shërbimin e markimit dhe monitorimit të karburanteve”	90
109. Kontratë Koncesioni/PPP “Për projektimin, financimin, dizenjimin, prodhimin dhe ngritjen e një sistemi për emetimin, shpërndarjen, gjetjen dhe monitorimin e pullave fiskale e të pullave të kontrollit të barnave”	90
Sektori i Zhvillimit Urban Dhe Ekonomik	91
111. Kontratë Koncesioni/PPP “Për përmirësimin e infrastrukturës Arsimore në Bashkinë Tiranë –Loti 4” me nr. 4907 Rep., dhe Nr. 1874 Kol., datë 08.09.2020.	92
112. Kontratë Koncesioni/PPP “Për dhënien me koncesion të aktivitetit të Regjistrit të Barrëve Siguruese” ...	93
113. Kontratë Koncesioni/PPP “Për dhënien me koncesion të aktivitetit të prodhimit të kripës në Nartë, Vlorë” ..	94
Sektori i Bujqësisë.....	94
114. Kontratë koncesioni/PPP “Për dhënien me koncesion të sipërfaqes deri në 1000 ha, në komunat Synej, Luz i Vogël, Kryevidh dhe Gosë, Kavajë për kultivimin e ullirit”	94
Sektori i Punëve të Brendshme.....	96

115. Kontratë koncesioni/PPP “Për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe pasaportave biometrike”	96
Lista e Kontratave të Koncesionit për vitin 2022	97
Aneks 1 - Koncepte dhe Kuadri Ligjor	105
Koncepti i Koncesioneve dhe Partneritetit Publik Privat	105
Kuadri Ligjor i Koncesioneve/PPP në Republikën e Shqipërisë	107

PËRMBLEDHJE

Raporti Vjetor i Përmbledhur është një dokument që hartohet çdo vit nga Ministria e Financave nëpërmjet Drejtorisë së Koncesioneve dhe paraqet një pamje të përgjithshme të performancës dhe ecurisë financiare dhe jo financiare ndër vite të kontratave koncesionare/PPP sipas sektorëve specifikë si: transporti, shëndetësia, arsimi, energjitika, mjedisi, zhvillimi urban, zhvillimi ekonomik dhe kontrolli fiskal.

Qëllimi i këtij raporti është të sigurojë një informacion të përmbledhur në lidhje me ecurinë dhe performancën e kontratave të Koncesioneve/PPP-ve në Republikën e Shqipërisë, në kuadër të përmirësimit të transparencës me publikun dhe publikohet në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 125/2013 “*Për koncesionet dhe partneritetin publik privat*”, i ndryshuar.

Me qëllim rritjen e transparencës mbi zbatimin e koncesioneve/PPP, forcimin e disiplinës financiare, monitorimin e risqeve fiskale dhe buxhetore që burojnë nga kontratat e koncesionit/PPP, me anë të Ligjit Nr. 50 datë 18.07.2019 “*Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”*” i ndryshuar, u miratuan disa ndryshime të cilat kanë përforcuar rolin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në monitorimin e zbatueshmërisë së projekteve të Koncesionit/PPP në këndvështrimin e implikimeve financiare.

Në këtë kuadër, përpara miratimit të këtyre ndryshimeve nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në muajin Mars të vitit 2019, filloi për herë të parë procesi i monitorimit të kontratave të koncesionit/PPP dhe raportimit nga Autoritetet Kontraktuese, në zbatim të paragrafit të dytë të pikës 121, seksioni IV të Udhëzimit plotësues nr. 1 datë 17.01.2019 “*Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2019*”. Me miratimin e ndryshimeve të ligjit “*Për koncesionet dhe partneritetin publik privat*”, raportimi në lidhje me ecurinë e zbatimit të kontratave koncesionare/PPP nga Autoritetet Kontraktuese bëhet në zbatim dhe sipas formateve të përcaktuara në Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 35, datë 12.12.2019.

Bazuar në pikën 7 të nenit 10 të Ligjit Nr. 125/2013 “*Për koncesionet dhe partneritetin publik privat*” i ndryshuar, Raporti Vjetor i Përmbledhur përgatitet dhe publikohet një herë në vit dhe është pjesë si aneks i raportit vjetor të zbatimit të buxhetit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor dhe kuadrin ligjor për koncesionet/PPP. Raporti Vjetor i Përmbledhur për vitin 2022 paraqet një pamje të përgjithshme të portofolit aktual të Koncesioneve/PPP, performancën e kontratave koncesionare, informacion në lidhje me ecurinë e investimit dhe zbatimit, ecurinë e pagesave buxhetore të parashikuara dhe të realizuara, si dhe risqet që rrjedhin nga këto kontrata koncesioni/PPP.

Njësitë përgjegjëse të cilat janë edhe aktorët kryesorë në monitorimin dhe raportimin e ecurisë së zbatimit të kontratave të koncesionit/PPP-ve janë: Autoritetet Kontraktuese dhe strukturat e tyre mbështetëse dhe ekzekutuese, njësitë brenda Ministrisë së Financave, përgjegjëse për përgatitjen e raportit vjetor të përmbledhur mbi ecurinë e zbatimit të kontratave të koncesionit/PPP, si dhe ATRAKO.

Në kuadër të monitorimit të ecurisë së zbatimit të kontratave koncesionare/PPP, Ministria e Financave nxit në vijimësi Autoritetet Kontraktuese për raportime periodike të plota dhe të standardizuara, për shmangien e vonesave në raportim si dhe për të rritur më tej rolin e tyre monitorues në lidhje me ecurinë e zbatimit të kontratave koncesionare/PPP. Vlerësohet se është e nevojshme të ndërmerren ndryshime ligjore, me qëllim shmangien e vonesave në raportimet periodike.

Hyrje

Ky raport prezanton një informacion të përmbledhur mbi ecurinë dhe zbatueshmërinë e kontratave të koncesionit/PPP në Republikën e Shqipërisë, bazuar në raportimet periodike të Autoriteteve Kontraktuese pranë Ministrisë së Financave lidhur me risqet fiskale dhe implikimet buxhetore për vitin 2022. Këto raportime janë realizuar duke u bazuar në/dhe sipas formateve të përcaktuara në Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 35, datë 12.12.2019, i cili është një Udhëzim që përcakton rregullat standarde, procedurat, afatet që duhet të ndiqen në procesin e raportimit dhe monitorimit të ecurisë dhe performancës financiare dhe jo financiare të kontratave të koncesionit/PPP nga të gjitha Autoritetet Kontraktuese.

Objekt i RVP-së janë të gjitha kontratat e koncesionit/PPP të lidhura në bazë të Ligjit nr. 7973, datë 26.7.1995 “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë”, Ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006, “Për Koncesionet”, Ligji nr. 125/2013, “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”, si dhe të gjitha kontratat e tjera të publikuara në Regjistrin e Koncesioneve në faqen zyrtare të ATRAKO-s. Në total, në Shqipëri deri në vitin 2022 rezultojnë:

- të nënshkruara 230 kontrata koncesionare,
- nga të cilat 215 janë pa mbështetje buxhetore dhe 15 me mbështetje buxhetore.
- Për vitin 2022 janë 11 kontrata koncesionare/ PPP aktive me mbështetje buxhetore.¹

Në zbatim të përcaktimeve të pikës 5 të nenit 10 të ligjit nr. 125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”, i ndryshuar, Ministria e Financave dhe Ekonomisë gjatë vitit 2022 ka dhënë rekomandime për Autoritetet Kontraktuese me qëllim marrjen e masave nga ana e tyre për përmirësimin e performancës në ofrimin e shërbimeve dhe punëve publike, objekt i kontratave të koncesionit fushë e tyre e përgjegjësisë, si dhe për minimizimin apo eliminimin e risqeve të drejtpërdrejta e të tërthorta që ndikojnë në buxhetin e shtetit.

Gjithashtu, i është kërkuar çdo Autoriteti Kontraktues që të ngrejë struktura monitoruese për çdo kontratë koncesioni edhe kur kontrata specifike nuk e përcakton një strukturë të tillë, me qëllim që informacioni i raportuar pranë Ministrisë së Financave të jetë i plotë, gjithëpërfshirës dhe në përputhje me përcaktimet ligjore.

1. Trendi i projekteve të koncesioneve dhe partneritetit publik privat në Shqipëri.

Pas viteve 2000, pati një rritje të kërkesë së aplikimit të koncesioneve dhe partneritetit publik privat nga qeveria shqiptare, me qëllim financimin e investimeve publike dhe ndërtimin e infrastrukturës publike.

Në figurën 1, është paraqitur ecuria ndër vite e kontratave koncesionare/PPP të miratuara në Shqipëri, që nga viti 2004. Një ndër projektet më të rëndësishme me impakt të gjerë të kësaj periudhe konsiderohet projekti i koncesionit të Aeroportit ‘Nënë Tereza’.


Gjatë viteve 2005-2013, një numër hidrocentralesh të vegjël u privatizuan², dhe disa të tjerë iu dhanë kompanive të huaja dhe vendase përmes kontratave koncesionare të llojit ROT, BOT dhe

¹ Burimi: Raporti i Buxhetit Faktik 2022, sipas linkut: <https://arkiva.financa.gov.al/paketa-e-projektligjit-te-buxhetit-faktik-2022/>

² Ligji nr.8527, datë 23.9.1999 “ Për privatizimin e hidrocentraleve vendore”.

BOO. Këto kontrata kanë pasur si qëllim rehabilitimin apo ndërtimin dhe shfrytëzimin e heceve të reja në burime hidrike të pashfrytëzuara. Pas vitit 2013, janë nënshkruar në total 54 kontrata koncesionare/PPP në sektorë të energjisë, transport, arsimit, shëndetësisë dhe mjedisit.

Figura nr. 1: Trendi i projekteve me Koncesioneve/PPP të nënshkruara ndër vite, 2004-2022




❖ **Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ATRAKO (2023)**

Përpjesa e vlerës së kontratave koncesionare/PPP me pagesa buxhetore ndaj PBB-së në fund të vitit 2022 rezultoi në 6.95%, në ulje krahasuar me nivelin faktik prej 8.97% e PBB-së në vitin 2021.

Për sa i përket formës së kërkuar të koncesioneve dhe partneritetit publik privat (shih figura 2), rreth 13 % e kontratave të miratuara në total janë propozime të kërkuara nga autoritetet kontraktues, në kuadër të një procedure përzgjedhëse konkurruese. Ndërsa pjesa tjetër e kontratave të miratuara janë propozime të pakërkuara që u janë ofruar autoriteteve kontraktuese me qëllim ofrimin e një shërbimi/investimi në fusha të ndryshme.

Figura nr. 2: Projekte Koncesion/PPP të kërkuara dhe të pakërkuara (%)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ATRAKO (2023)

Me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 50 datë 18.07.2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, është kufizuar pranimi i propozimeve të pakërkuara vetëm në porte, aeroporte dhe sektorin e energjisë dhe janë hequr propozimet e pakërkuara në të gjitha fushat e tjera të dhënies me koncesion/PPP që përcakton Ligji Nr. 125/2013, i ndryshuar.

Referuar figurës 3, numri total i kontratave koncesionare/PPP të miratuara për periudhën 2004-2013 shënon vlerën 176 në total, ndërsa gjatë periudhës 2014-2022 janë miratuar 54 kontrata koncesionare/PPP.


Figura nr. 3: Numri total i kontratave koncesionare/PPP të miratuara për periudhat 2004-2013 dhe 2014-2022



❖ *Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ATRAKO, (2023)*


Në total, numri i kontratave të koncesioneve/PPP të miratuara në Shqipëri deri në vitin 2022 shënon 230 kontrata, 6 prej tyre janë zgjidhur, si rezultat numri aktual i kontratave aktive të koncesionit/PPP është 224. Numri më i madh i tyre ka si Autoritet Kontraktues Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, me 208 kontrata koncesionare/PPP (shih Figurën 4). Ndërkohë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është Autoritet Kontraktues në 4 kontrata koncesionare në fushën e shëndetësisë, ndërsa Ministrinë e tjera të linjës dhe Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore sipas figurës së mëposhtme.

Figura nr. 4: Numri i kontratave Koncesionare/PPP sipas Autoritetit Kontraktues që ka nënshkruar kontratën në total



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ATRAKO, (2023)

Figura nr. 5: Numri dhe vlera totale e investimit (në Lekë) të projekteve Koncesionare/PPP aktive sipas sektorëve, 2022



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ATRAKO, (2023)

Referuar figurës 5, sektori që ka peshën më të madhe të kontratave në numër dhe në vlerë është sektori i energjisë me 183 kontrata, me një vlerë totale prej 415.2 miliardë Lekësh.

Sektori i dytë me peshë më të madhe përta i përket vlerës së kontratave është sektori i transportit, me 21 kontrata, me vlerë totale 123.8 miliardë Lekë. Ndërkohë sektori i mjedisit ka në total 6 kontrata me vlerë 25.8 miliardë Lekësh të cilat konsistojnë në ngritjen e sistemit të përpunimit të mbetjeve, menaxhimin e pyjeve, si dhe shfrytëzimin e burimeve ujore.

Përta i përket sektorit të shëndetësisë, në total janë miratuar 4 kontrata koncesionare/PPP me vlerë prej 4.2 miliardë Lekësh. Ndërsa, në kategorinë ‘Të tjera’, janë përfshirë në total 10 kontrata koncesionare me vlerë 11.3 miliardë Lekë të shpërndara në sektorin e bujqësisë, sektorin e kontrollit fiskal, sektorin e zhvillimit ekonomik dhe urban.


Përta i përket formës së mbështetjes financiare:

- Nga sektori publik, në total janë lidhur 15 kontrata koncesionare/PPP me mbështetje buxhetore, nga të cilat, për vitin 2022 11 kontrata janë aktive, apo rreth 6% e totalit të kontratave.
- Ndërsa kontratat pa mbështetje buxhetore në total janë 209.

Referuar figurës 6 përqindja e pagesave buxhetore ndaj totalit të të ardhurave tatimore të vitit paraardhës buxhetor, ka rezultuar rreth 2.66% për vitin 2022 nën kufirin maksimal të rregullit fiskal

prej 5%. *Gjithashtu në bazë të pagesave buxhetore të planifikuara ky tregues parashikohet të jetë në rënie edhe për vitet në vijim nën kufirin maksimal të rregullit fiskal.*


Tabela 6: Përqindja e pagesave buxhetore ndaj totalit të të ardhurave tatimore të vitit paraardhës buxhetor



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë³ (2023)

Nëse i referohemi pagesave buxhetore për kontratat koncesionare/PPP me mbështetje buxhetore, në vitin 2022 janë realizuar rreth 12.64 miliardë Lekë pagesa buxhetore.

Figura nr. 7: Pagesat buxhetore për kontratat me mbështetje buxhetore



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

³ Burimi: Treguesit Fiskal sipas Buxhetit të Konsoliduar, sipas linkut: <https://arkiva.financa.gov.al/3014-2/> si dhe Raporti i Buxhetit Faktik 2022, sipas linkut: <https://arkiva.financa.gov.al/paketa-e-projektligjit-te-buxhetit-faktik-2022/>

2. Prezantim i ecurisë së Kontratave Koncesionare/PPP në Shqipëri

Në total në Shqipëri deri në vitin 2022 rezultojnë 230 kontrata nga të cilat 224 kontrata koncesionare aktive në sektorin e transportit, energjisë dhe gazit, mjedisit, transporti, zhvillimit urban, zhvillimit ekonomik, shëndetësisë, kontrollit fiskal dhe arsim. Në vijim të këtij materiali jepet përshkrimi për ecurinë e kontratave të klasifikuara sipas sektorëve.

Sektori i Transportit⁴

Ky sektor është një nga sektorët që zë një pjesë të rëndësishme përse u përket kontratave të koncesionit/PPP, si në fushën e transportit rrugor ashtu edhe në fushën e transportit ajror dhe detar, ku një pjesë e konsiderueshme e tyre aktualisht ndodhen në fazën e operimit. Në këtë raport referuar informacioneve të përcjella nga autoriteti përgjegjës, janë përzgjedhur për t'u prezantuar kontratat si më poshtë:

1. Kontrata Koncesionare/PPP “Për ndërtimin, përmirësimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e autostradës Milot-Morinë”

Objekti i kontratës koncesionare/PPP është përmirësimi i Autostradës “Milot-Morinë”, shfrytëzimi dhe mirëmbajtja efikase e saj nga ana e shoqërisë koncesionare, sipas një pakete të paracaktuar të standardeve të performancës. Data efektive e kontratës është data 09.09.2017.

Sipas raportimeve dhe konfirmimit të Autoritetit Kontraktues, gjatë vitit 2022 projekti është në fazën e ndërtimit dhe të operimit. Sipas raportimeve shoqëria koncesionare vazhdon të realizojë punimet e mirëmbajtjes së autostradës “Milot-Morinë”, si dhe punime përmirësuese të komponentëve të ndryshëm përgjatë autostradës me qëllim rritjen e nivelit të sigurisë.

- **Autoriteti Kontraktues:** Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.
- **SPV:** “Albania Highway Concession Company”
- **Vlera e Investimit:** 5,3 miliardë Lek
- **Data e fillimit të kontratës:** 09 Mars 2017
- **Kohëzgjatja e kontratës:** 30 vjet
- **Faza aktuale e projektit:** Ndërtim dhe Operim
- **Forma :** Propozim i kërkuar

Kjo kontratë koncesionare referuar mënyrës së shpërblimit të koncesionarit, realizimin e të ardhurave e ka të parashikuar në formën e tarifave për kalim nga përdoruesit e rrugës ndaj koncesionarit. Gjithashtu, kontrata parashikon garantimit nga ana e autoritetit kontraktues e një pragu të të ardhurave nga trafiku të përcaktuar në kontratë si dhe ndarjen e tyre midis koncesionarit dhe Autoritetit Kontraktues në rast të tejkalimit të këtij pragu. Ndërkohë për realizimin e veprave të artit të përcaktuara në kontratë një pjesë e kostos së tyre mbulohet nëpërmjet subvencionimit nga buxheti i shtetit.

Në tabelën 1 janë dhënë vlerat e pagesave nga buxheti i shtetit të realizuara dhe planifikuara ndër vite. Për vitin 2022 sipas raportimit nga Autoriteti Kontraktues, financimi nga buxheti i shtetit ka qenë në vlerën 740.9 milion Lekë, me një realizim prej 100% nga plani vjetor 2022.

⁴ Informacion i hartuar në bazën e raportimeve të Autoritetit Kontraktues.

Tabela 1: Pagesat buxhetore për projektin objekt kontrate “Milot-Morinë”

Viti	2018		2019		2020		2021		2022 ⁵	
	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Pagesat Buxhetore (në mijë Lekë)	310,000	308,183	575,753	570,642	813,259	811,734	740,259	790,027	740.978	740,978

❖ Risqet

Nga 12 risqe të identifikuar, Autoriteti Kontraktues ka mbajtur 3 risqe: riskun politik, riskun e qeverisjes dhe riskun e ndryshimeve ligjore, ndërsa tek Partneri Privat janë transferuar risku i ndërtimit, risku i transferimit të asetëve, risku i operimit dhe performancës dhe risku i ribalancimit të ekuilibrit financiar. Ndërkohë, risku i kërkesës, risku financiar, risku i forcës madhore, risku i rinegociimit dhe risku i ndërprerjes së kontratës janë ndarë mes palës private dhe publike. Për vitin 2022 nuk është raportuar materializimi i ndonjë risku, por risku financiar, risku i forcës madhore, risku i rinegociimit dhe risku i veprimeve negative të qeverisë (MAGA) janë klasifikuar si risqe të mesme dhe për riskun MAGA.

2. Kontrata Koncesionare/PPP “Për ndërtimin, përmirësimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e Rrugës së Arbrit”

Objekti i kësaj kontrate koncesioni/PPP është ndërtimi, përmirësimi, shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e “Rrugës së Arbrit” nga ana e shoqërisë koncesionare për 13 vite, duke u nisur nga data efektive e saj 04.07.2018.

Sipas raportimeve dhe konfirmimit të Autoriteti Kontraktues, gjatë vitit 2022 kanë përfunduar 49 km trup rrugë në stadin e punimeve të avancuara, ku në 38 km është hedhur shtresa e konglomeratit bituminos dhe binder, pjesë e shtresave asfaktike, kanë përfunduar 5 Tunelet e rinj, me të gjitha elementet (përfshi edhe ndriçimin), ka përfunduar ndërtimi i 2 urave beton - arme, përkatësisht mbi Lumin e Zallit të Bulqizës (144 m e gjatë) dhe mbi lumin Drin (260 m e gjatë), ka përfunduar Ura e Vashës dhe Ura e Fshatit Fshat, si dhe është përfunduar By Pass-i i Murrizit, një gjatësi prej 9.6 km. Ka përfunduar punimet deri në shtresë Konglomerati në segmentin rrugor para hyrjes së Tunelit të Murrizit, ku janë përfunduar pilotat, punimet e mbrojtjes me mur të përforcuar H=18m (terra-mesh), mbushje me material karriere mbi murin terra-mesh dhe shtresat rrugore. Në vijim, është ndërtimi i Tunelit të Murrizit me ecuri realizimi (hapje) 91%, ku pavarësisht vështirësive si pasojë e formacionit gjeologjik ku u pezualluan punimet për 17-muaj në këtë vepër, po punohet në të dy tubat nga të 4 (katërt) portalet, ku deri më tani avancimi është rreth 3.16 km në tubin kryesor dhe 3.73 km në tubin e emergjencës, nga 3.78 km për gjatësi tubi (pra në atë kryesor dhe në atë të emergjencës).

- **Autoriteti Kontraktues:** Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.
- **SPV:** “Gjoka 87 sh.p.k”
- **Vlera e Investimit:** 26.5 miliardë Lek
- **Data e fillimit të kontratës:** 11 Korrik 2018
- **Kohëzgjatja e kontratës:** 13 vjet
- **Faza aktuale e projektit:** Ndërtim dhe operim
- **Forma :** Propozim i pakërkuar

Përsa i përket llojit të financimit ky projekt koncesionar/PPP është me mbështetje buxhetore, pagesat e të cilit kanë filluar në vitin 2019 (shih tabela 2). Autoriteti Kontraktues ka përmbushur

⁵ Burimi: Raporti i Buxhetit Faktik 2022, sipas linkut: <https://arkiva.financa.gov.al/paketa-e-projektligjit-te-buxhetit-faktik-2022/>

detyrimin e pagesës për realizimin e punimeve të ndërtimit mbi 25% të ecurisë së punimeve dhe pagesat kanë filluar të kryhen sipas Modelin Financiar të kontratës. Pagesat faktike të vitit 2022 janë në masën rreth 2.9 miliardë lekë, duke rezultuar me një realizim 100% nga plani vjetor i buxhetit për vitin 2022, të cilat konsistojnë në "Ndërtim, Operim, Mirëmbajtje" dhe "Supervizion i punimeve të Kontrates" dhe "Oponencë Teknike".

❖ *Tabela 2: Pagesat buxhetore për projektin objekt kontrate "Rruga e Arbrit"*

Viti	2018		2019		2020		2021		2022	
	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Pagesat Buxhetore (në mijë Lekë)	1,000	0	3,913,800	3,910,860	2,689,110	2,689,054	3,393,000	3,392,727	2,940,000	2,940,000

❖ *Risqet*

Autoriteti Kontraktues ka raportuar në lidhje me risqet e kontratës sipas formatit të përcaktuar, duke specifikuar përcaktimin e palës që merr përsipër riskun. Autoriteti Kontraktues ka mbajtur 3 prej tyre: riskun politik, riskun e aksesit në zonën e projektit dhe riskun e ndryshimeve ligjore, ndërsa tek Partneri Privat janë transferuar 5 risqet kryesore si: risku i projektimit, ndërtimit, disponueshmërisë, risku i operimit dhe mirëmbajtjes, risku i transferimit të aseteve dhe risku i ribalancimit të ekuilibrit financiar. Ndërkohë, risku i forcës madhore, risku i rinegocimit dhe risku i ndërprerjes së kontratës janë ndarë mes palës private dhe publike.

3. Kontrata e koncesionit/PPP "Për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e segmentit rrugor "Milot Balldren"

Objekti i kësaj kontrate koncesioni/PPP është projektimi, ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrugës "Milot Balldren".

Referuar raportimeve të Autoritetit Kontraktues rezultojnë se, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues me shkresën nr. 1069/3 datë 16.12.2021, i ka dërguar shoqërisë "ANK" sh.p.k., si Koncesionari, dhe shoqërisë "Bardh Konstruksion" sh.p.k., si Shoqëria Koncesionare, njoftimin për zgjidhjen e kontratës së Koncesionit/PPP "Për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e segmentit rrugor "Milot-Balldren", si rezultat i mospërbushjes së kushteve të kontratës së koncesionit/PPP nga ana e Shoqërisë Koncesionare dhe Koncesionarit, të parashikuara në nenin 7 "Mospërbushja e Kushteve Paraprake" si dhe në pikën 4.2 të nenit 21 "Përmblyllja Financiare".

- **Autoriteti Kontraktues:** Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.
- **SPV:** Bardh Konstruksion sh.p.k
- **Vlera e Investimit:** 17.7 miliardë Lek
- **Data e fillimit të kontratës:** 27.03.2019
- **Kohëzgjatja e kontratës:** 13 vjet
- **Faza aktuale e projektit:** Në fazën e plotësimit të kushteve paraprake për zbatimin e projektit

4. Kontrata e koncesionit/PPP “Për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugës “Porti i Jahteve- By Pass Orikum Dukat (Ura e Shën Elizës)”

Objekti i kësaj kontrate koncesioni është projektimi, ndërtimi dhe mirëmbajtja e Rrugës “Porti i Jahteve- Bypass Orikum- Dukat (Ura e Shën Elizës)”. Me përmbushjen e kushteve paraprake të kontratës dhe dorëzimit të sheshit të Terriorit të projektit nga autoriteti kontraktor në muajin shkurt 2021, Shoqëria Koncesionare filloi zbatimin e punimeve ndërtimore sipas projektit të miratuar, punime të cilat do të implementohen për 36 muaj.

- **Autoriteti Kontraktues:** Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.
- **SPV:** ‘Ruga Orikum-Llogara’ sh.p.k
- **Vlera e Investimit:** 5.81 miliardë Lek
- **Data e fillimit të kontratës:** 18.07.2019
- **Kohëzgjatja e kontratës:** 13 vjet
- **Faza aktuale e projektit:** Ndërtim
- **Forma:** Propozim i pakërkuar

Sipas raportimeve nga ana e Autoriteti Kontraktues, gjatë vitit 2022 punimet e zbatimit kanë ecur me ritëm, sipas grafikut të punimeve të cilat janë monitoruar dhe certifikuar nga inxhinieri i pavarur i kontratës. Gjithashtu, në kuadër të zbatimit të kontratës, janë marrë masat nga autoriteti kontraktor dhe institucionet përgjegjëse, për kryerjen dhe ndjekjen e procedurave ligjore për shpronësimet për pronarët e pasurive të paluajshme që preken nga ndërtimi i rrugës. Përsa i përket llojit të financimit ky projekt koncesionar/PPP është me mbështetje buxhetore, Pagesat faktike të vitit 2022 rezultojnë në masën rreth 224.7 milion lekë, duke rezultuar 100 përqind e pagesave të planifikuara për vitin 2022, sipas planit të ndryshuar.

❖ **Tabela 3: Pagesat buxhetore për projektin objekt kontrate “Ruga Orikum-Dukat”**

Viti	2021		2022	
	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Pagesat Buxhetore (në mijë Lekë)	48,029	47,069	224,699	224,698

❖ **Risqet**

Autoriteti ka raportuar në lidhje me risqet e kontratës duke specifikuar përcaktimin e palës që merr përsipër riskun. Autoriteti Kontraktues ka mbajtur riskun e aksesit në zonën e projektit, kurse Partneri Privat janë transferuar risku i trullit, risku i projektimit, ndërtimit, etj.

5. Kontrata Koncesionare/PPP “Ndërtimi, vënia në punë, operimi dhe mirëmbajtja e Aeroportit ‘Nënë Tereza’”

Objekti i kësaj kontrate koncesioni/PPP konsiston në zhvillimin e dy fazave A dhe B ku përfshihet projektimi, financimi, operimi, ndërtimi, vënia në punë, mirëmbajtja dhe administrimi/zhvillimi i terminalit të ri të aeroportit, duke lejuar zgjerimin e tij në të ardhmen.

Sipas raportimeve dhe konfirmimit të Njësisë së Zbatimit të Projektit, gjatë vitit 2022 projekti ka qenë në fazën e operimit. Shoqëria koncesionare “TIA” sh.p.k, ka dorëzuar Masterplanin e përditësuar të Aeroportit në përputhje me kërkesat e vendosura në marrëveshjen koncesionare (Master Plani dhe Planifikimi i Mjediseve). Përgjatë dy fazave është realizuar ripërtëritja, vënia në punë dhe mirëmbajtja e terminalit ekzistues, ka përfunduar ndërtimi dhe vënia në punë e qendrës së re së kargos, si dhe është realizuar mirëmbajtja e Perimetrit të Rrethimit të sigurisë së Aeroportit në përputhje me detyrimet e marrëveshjes koncesionare.

Shoqëria koncesionare ka përfunduar fazën e parë të projektit ‘Airfield 2020’, ndërkohë rehabilitimi i pistës dhe rrugëve lidhëse që mundësojnë lëvizjen e avionëve në zonën ajrore ka vijuar gjatë vitit 2022. Autoriteti Kontraktues raporton se shoqëria koncesionare përgjatë vitit 2022 ka ndërmarrë veprimet në lidhje me investime e parashikuara, në vlerësim të rritjes së volumit të trafikut përgjatë këtij viti për të siguruar një nivel shërbimi dhe operimi sa më të mirë kundrejt pasagjerëve dhe kompanive ajrore. Është realizuar dhe ka filluar projekti dhe investimi zgjerimit të terminalit, përfshirë përmirësimin dhe rinovimin e terminalit si dhe me pajisjet e sigurisë brenda terminalit (planifikuar në marrëveshje për vitin 2024).

Një tjetër tregues i performancës së këtij projekti është trendi në rritje ndër vite i numrit të pasagjerëve që kanë përdorur shërbimin e ofruar nga ky koncesion. Statistikat që nga viti 2012 janë të paraqitura në tabelën 4.

❖ **Tabela 4: Numri i pasagjerëve ndër vite**

Viti	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Nr.Pasagjerëve	1,665,331	1,757,342	1,810,305	1,977,044	2,195,100	2,630,338	2,947,172	3,338,147	1,310,614	2,923,533	5'198'579

❖ Risqet

Në lidhje me këtë kontratë koncesioni, është raportuar probabilitet i ulët për riskun e qeverisjes, riskun e ndërtimit, riskun e kërkesës, riskun financiar, riskun e rinegociimit dhe riskun e ndërprerjes së kontratës. Ndërkohë Autoriteti Kontraktues ka raportuar për një probabilitet të mesëm për riskun operacional.

- **Autoriteti Kontraktues: OSHA**
(Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë)
- **SPV: “Tirana International Airport”**
sh.p.k
- **Vlera e Investimit: 9.1 miliardë Lekë**
- **Data e fillimit të kontratës: 23 Prill 2005**
- **Kohëzgjatja e kontratës: 35 vite**
- **Faza aktuale e projektit: Operim dhe Ndërtim**

6. Kontratë Koncesioni /PPP “Për rehabilitimin, operimin, transferimin e aeroportit të Kukësit”

Objekti i kësaj kontrate koncesioni është rehabilitimi, operimi dhe transferimi i “Aeroportit të Kukësit”. Referuar raportimeve të Autoritetit Kontraktues gjatë vitit 2022 ky projekt ndodhet në fazën e operimit si dhe gjatë vitit 2022 janë realizuar 100% e punimeve ndërtimore. Në muajin mars të vitit 2021 ky aeroport ka filluar operimin e tij. Autoriteti raporton se nuk janë përmbushur 100% kushtet paraprake për shkak se rruga që lidh Aeroportin me Autostradën nuk është përfunduar totalisht nga ana e Autoritetit Kontraktues, kusht i cili, nuk çënon operimin e aeroportit. Numri i pasagjerëve për vitin 2022, raportuar nga Autoriteti Kontraktues, është 39,753.

- **Autoriteti Kontraktues:** Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.
- **SPV:** “Kukës International Airport” sh.p.k
- **Vlera e Investimit:** 987,9 milionë Lek
- **Data e fillimit të kontratës:** 20 Mars 2019
- **Kohëzgjatja e kontratës:** 35 vjet
- **Faza aktuale e projektit:** Përmbushje e kushteve paraprake kontraktuale për zbatimin e projektit
- **Forma:** Propozim i Kërkuar

❖ Risqet

Në bazë të raportimeve, konstatohet se risqet e alokuara tek koncesionari janë risku i kërkesës, risku i qeverisjes, risku i ndërtimit, risku i operimit dhe të performancës, risku i ndryshimeve ligjore dhe risku i ribalancimit të ekuilibrit financiar, ndërsa risqet e ndara mes autoritetit kontraktues dhe shoqërisë koncesionare janë risku financiar, risku i forcës madhore, risku i rinegociimit dhe risku i ndërprerjes së kontratës.

7. Kontratë Koncesioni/PPP “Për Menaxhimin, Operimin dhe Mirëmbajtjen e Terminalit të trageteve të Portit të Durrësit”

Objekti i kësaj kontrate koncesioni është investimi, menaxhimi, operimi, mirëmbajtja dhe përmirësimi teknik, si dhe adaptimi për të përmbushur kërkesat aktuale dhe të ardhshme të trafikut në Terminalin e Trageteve dhe Krocerave Durrës. Referuar raportimeve të Autoritetit Kontraktues, gjatë vitit 2022 ky projekt ka qenë në fazën e zbatimit. Për vitin 2022 Autoriteti Kontraktues ka raportuar se projekti është pezulluar për shkak të mosndërtimit të kalatës 9-c. Deri me tani nga Koncesionari është realizuar 23% e vlerës së parashikuar prej 4,130,000 €.

- **Autoriteti Kontraktues:** Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.
- **SPV:** “Albania Ferry Terminal Operator” sh.p.k
- **Vlera e Investimit:** 581 milionë Lek
- **Data e fillimit të kontratës:** 11 Shtator 2013
- **Kohëzgjatja e kontratës:** 25 vjet
- **Faza aktuale e projektit:** Operim
- **Forma:** Propozim i Pakërkuar

Niveli i kërkesës së arritur gjatë vitit 2022 është është 1,069,659 volume (pasagjerë dhe mjete), nga 1,484,729 volume të planifikuara gjatë kësaj periudhe. Specifikisht treguesit e performancës kanë patur ecurinë e mëposhtme:

- *Volumi i Pasagjerëve-* Gjatë kësaj periudhe volumi ka qënë **802,679** pasagjerë nga 1,132,447 të parashikuar për këtë periudhë.
- *Volumi i mjeteve-* Gjatë kësaj periudhe kanë kaluar **266,980** mjete, nga 352,282 të parashikuar për këtë periudhë.

❖ Risqet

Autoriteti ka raportuar edhe në lidhje me risqet e kontratës, duke e konsideruar me probabilitet të mesëm për të ndodhur riskun e ndërtimit, riskun e operimit dhe performancës dhe riskun e kërkesës

(mosrealizimi i kërkesave aktuale dhe të ardhshme të trafikut), risqe të cilat janë alokuar tek koncesionari në rast materializimi. Gjithashtu edhe risku financiar është alokuar tek koncesionari. Ndërkohë risqet e alokuara Autoritetit Kontraktues janë risku i qeverisjes, risku i ndryshimeve ligjore dhe risku material nga vendimet politike. Ndërsa risku i negocimit dhe risku i ndërprerjes së kontratës janë ndarë mes Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit.

8. Kontratë Koncesioni/PPP “Për Rehabilitimin, Operimin dhe Transferimin e Infrastrukturës Hekurudhore Fier-Ballsh, Fier Vlorë”

Objekti i kësaj kontrate koncesioni është rehabilitimi i infrastrukturës hekurudhore, operimi si administrues infrastrukture dhe transportues hekurudhor i integruar, të rrjetit të transportit hekurudhor Fier-Ballsh dhe Fier- Vlorë dhe transferimi i tyre nga shoqëria koncesionare tek Autoriteti Kontraktues.

Referuar raportimeve dhe konfirmimit të Autoritetit Kontraktues, gjatë vitit 2022 ky projekt ka qenë në fazën e zbatimit. Për vitin 2022 nuk janë zhvilluar investime të rëndësishme që lidhen me rehabilitimin e infrastrukturës hekurudhore. Bazuar në raportimin e Autoritetit Kontraktues progresi i punimeve është në masën 46%.

Gjithashtu, Autoriteti Kontraktues ka raportuar se nuk ka arritur të sigurojë financim nga Bankat për rehabilitimin e infrastrukturës hekurudhore Fier-Ballsh, për shkak të riskut që paraqet ky projekt, i cili lidhet kryesisht me mos funksionimin e vazhdueshëm të rafinerisë së Ballshit (në proces demolimi). Shoqëria Koncesionare ka kërkuar shtyrjen e periudhës së rehabilitimit, për çështje që lidhen edhe me forcën madhore, okupimet e pronave si dhe zënien e trasesë hekurudhore nga vagonët e “HSH” Sh.a në Ballsh. Kërkesë e cila është duke u shqyrtuar nga ana e Autoritetit Kontraktor.

❖ Risqet

Në bazë të raportimeve, konstatohet se risqet e alokuara tek koncesionari janë risku i kërkesës, risku i ndërtimit, risku i operimit dhe të performancës, dhe risqet financiare, ndërsa risqet e ndara mes autoritetit kontraktues dhe shoqërisë koncesionare janë risku i forcës madhore, risku i rinegociimit, risku i veprimeve negative të qeverisë dhe i ndryshimit të ligjit si dhe risku i ndërprerjes së kontratës. Autoriteti ka raportuar se probabiliteti që risku i kërkesës dhe risku i forcës madhore të materializohet është i mesëm, ndërsa risqet e tjera kanë probabilitet të ulët për tu materializuar.

- **Autoriteti Kontraktues:** Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.
- **SPV:** “ALBRAIL” sh.p.k
- **Vlera e Investimit:** 2.4 miliard Lek
- **Data e fillimit të kontratës:** 11 Prill 2017
- **Kohëzgjatja e kontratës:** 25 vjet
- **Faza aktuale e projektit:** Operim
- **Forma:** Propozim i Pakërkuar

Sektori i Mjedisit

Në sektorin e mjedisit janë miratuar projektet si: Inceneratori i Tiranës, Inceneratori i Fierit dhe Inceneratori i Elbasanit, të cilat konsistojnë në ndërtimin e impianteve të përpunimit të mbetjeve urbane, dhe Landfill-i Kamzës, i cili ka si qëllim menaxhimin e mbetjeve për Bashkinë e Kamzës. Gjithashtu, në sektorin e mjedisit përfshihen edhe shfrytëzimi i burimit ujor në Sasaj, Bunec dhe kontrata e fidanishtes së Cërrikut.

9. Kontrata Koncesionare/PPP “Për Ndërtim Landfilli, Inceneratori dhe Rehabilitim i Venddepozitimeve Ekzistuese Tiranë dhe Prodhimin e Energjisë Elektrike”

Kontrata e koncesionit lidhur midis Ministrisë së Mjedisit dhe shoqërisë “Integrated Energy BV SPV” sh.p.k, e lidhur në 31 gusht 2017 ka për objekt dhënien me koncesion të formës BOT (ndërtim, operim dhe transferim i të drejtës së pronësisë dhe operimit, në përfundim të kontratës koncesionare), financimin, projektimin, rehabilitimin, ndërtimin, vënien në punë, administrimin, operimin dhe mirëmbajtjen e Veprave dhe të Veprave Plotësuese për Mbetjet e Qarkut Tiranë, si dhe prodhimin e energjisë elektrike, për periudhën e koncesionit (ashtu siç definohet në nenin 4 të kontratës koncesionare), si dhe transferimin e tij në përfundim të kontratës nga Koncesionari tek Autoriteti Kontraktues, konform kushteve dhe afateve kontraktuale.

- **Autoriteti Kontraktues:** Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë/Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
- **Autoritet i Përfshirë:** Bashkia e Tiranës dhe Njësitë e Qeverisjes Vendore Qarku Tiranë
- **SPV:** “Integrated Energy BV SPV”
- **Vlera e Investimit:** 17,1 miliardë Lekë
- **Data e fillimit të kontratës:** 31 Gusht 2017
- **Kohëzgjatja e kontratës:** 30 vjet
- **Faza aktuale e projektit:** Ndërtim & Operim

Përsa i përket llojit të financimit, sipas kontratës koncesionare ky projekt koncesionar/PPP është me pagesa të formës “pay per use” ose pagesa e një tarife fikse për çdo ton mbetjesh të depozituara, e cila paguhet nga Njësitë e Qeverisjes Vendore Qarku Tiranë për mbetjet që depozitojnë.

Me vendimin nr. 95, datë 28.07.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, është vendosur masa e sekuestros për pasuritë e shoqërisë “Integrated Energy BV S.P.V” sh.p.k dhe shoqërisë “Integrated Technology Servis” sh.p.k, shoqëri të cilat administrohen nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, në zbatim të legjislacionit në fuqi për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara⁶.

Për vitin 2022, informacioni jepet si më poshtë:

❖ **Tabela 5: Pagesat vjetore të realizuara (faktike) për projektin objekt i kësaj kontrate – Bashkia Tiranë**

Viti	2018		2019		2020		2021		2022 ⁷	
	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Pagesat buxhetore (në mijë)	977,000	977,000	977,125	977,125	1,280,000	1,280,000	1,300,000	1,249,399	1,052,990	1,046,397

❖ Risqet

Nga risqet e identifikuara, Autoriteti Kontraktues ka mbajtur riskun e vendodhjes, riskun politik dhe riskun ekonomik, ndërsa partneri privat ka mbajtur riskun financiar, riskun e projektimit dhe riskun e transferimit të aseteve. Ndërkohë, risku i lejeve dhe licensave, risku i forcës madhore, risku i rinegociimit dhe risku i ndërprerjes së kontratës janë ndarë mes të dyja palëve.

⁶ Informacion i disponueshëm gjatë periudhës së draftimit të raportit të përmbledhur vjetor të vitit 2022.

⁷ Burimi: Raporti i Buxhetit Faktik 2022, sipas linkut: <https://arkiva.financa.gov.al/paketa-e-projektligjit-te-buxhetit-faktik-2022/>

10. Kontrata Koncesionare/PPP “Për Ndërtimin e Administrimin e Impjantit të Trajtimit të Mbetjeve Urbane të Qarkut Fier dhe Prodhimin e Energjisë”

Objekti i kontratës së koncesionit është financimi projektimi, ndërtimi, vënia në punë, administrimi dhe mirëmbajtja e impiantit të përpunimit të mbetjeve të Qarkut Fier dhe prodhimi i energjisë elektrike. Data efektive e kësaj kontrate është data 30 Nëntor 2016.

Me vendimin nr. 134, datë 28.03.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, shoqëria “Integrated Technology Services” sh.p.k dhe shoqëria “Integrated Technology Waste Treatment Fier” sh.p.k janë vendosur në masë sigurimi pasuror “sekuestro preventive”, së bashku me të gjitha pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme, në pronësi të tyre dhe administrohen nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara.

- **Autoriteti Kontraktues:** Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë/Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
- **SPV:** “Integrated Technology Waste Treatment Fier” Sh.p.k
- **Vlera e Investimit:** 3.72 miliardë Lek
- **Data e fillimit të kontratës:** 30 Nëntor 2016
- **Kohëzgjatja e kontratës:** 6 vjet
- **Forma:** Propozim i pakërkuar

❖ Tabela 6: Pagesat vjetore të realizuara (faktike) për projektin objekt i kësaj kontrate

Viti	2018		2019		2020		2021		2022 ⁸	
	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Pagesat buxhetore (në mijë Lekë)	752,772	752,771	752,772	725,770	755,500	752,770	752,771	690,040	376,400	376,385

❖ Risqet

Risqet e kësaj kontrate koncesionare vijojnë të mbeten të njëjta me vitin 2021. Autoriteti Kontraktues ka mbajtur riskun e qeverisjes, riskun politik dhe riskun e ndryshimeve ligjore, ndërsa partneri privat ka mbajtur riskun financiar, riskun e vendodhjes, riskun e operimit (menaxhimi i impiantit, menaxhimi i mbetjeve) dhe riskun e transferimit të aseteve. Ndërkohë risku i forcës madhore, risku i rinegocimit, risku i ndërprerjes së kontratës, risku i kërkesës dhe risku i ndërtimit janë ndarë mes të dyja palëve.

⁸ Burimi: Raporti i Buxhetit Faktik 2022, sipas linkut: <https://arkiva.financa.gov.al/paketa-e-projektligjit-te-buxhetit-faktik-2022/>

11. Kontrata Koncesionare/PPP “Për Ndërtimin dhe Administrimin e Impiantit të Përpunimit të Mbetjeve Urbane të Qarkut të Elbasanit”

Objekti i kësaj kontrate është projektimi, ndërtimi dhe vënia në punë, administrimi, mirëmbajtja dhe transferimi në përfundim të afatit të kontratës i inceneratorit të Bashkia Elbasan. Në lidhje me veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektike janë miratuar:

Vendimi Nr. 39 Prot., datë 28.04.2022 i Entit Rregullator të Energjisë (ERE) “Mbi licencimin e shoqërisë “Eco – Elb” sh.a në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektike nga centrali i përpunimit të mbetjeve urbane, me kapacitet 2850 kW”, Fletore Zyrtare me nr. 84 datë 06.06, 2022, si dhe Vendimi nr.159, datë 17.06.2022, i Entit Rregullator të Energjisë (ERE) “Mbi kërkesën e shoqërisë “Albtek Energy” sh.p.k. për përcaktimin e çmimit të energjisë elektrike të prodhuar nga impianti i trajtimit të mbetjeve urbane në qytetin e Elbasanit”, Fletore Zyrtare me nr.103, datë 12.07 2022.

Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara ka në administrim Shoqërinë “AlbTek Energy” sh.p.k, sekuestruar me vendim nr.484 datë 13.12.2021 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Për shoqërinë “AlbTek Energy” sh.p.k nga buxheti i shtetit nuk ka asnjë pagesë për vitin ushtrimor 2022.⁹

- **Autoriteti Kontraktues:** Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë/Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (zbatues Bashkia Elbasan).
- **SPV:** “AlbTek Energy” sh.p.k
- **Vlera e Investimit:** 3 miliardë Lek
- **Data e fillimit të kontratës:** 16 dhjetor 2014
- **Kohëzgjatja e kontratës:** 7 vjet

Viti	2018		2019		2020		2021 ¹⁰		2022	
	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Pagesat buxhetore (në mijë Lekë)	661,500	601,429	661,500	631,317	586,770	582,720	50,000	40,292	-	-

12. Kontrata Koncesionare/PPP “Për dhënien me konçesion/PPP të shërbimit të pastrimit, grumbullimit, transportimit, dhe seleksionimit të mbetjeve urbane të Bashkisë Kamëz”

Objekti i kësaj kontrate koncesioni/PPP është grumbullimi, transportimi, dhe seleksionimi të mbetjeve urbane të Bashkisë Kamëz". Data efektive e kontratës është data 24.05.2018.

Referuar raportimeve dhe Konfirmimeve të Autoritetit Kontraktues, gjatë vitit 2022 kjo kontratë ndodhet në fazë ndërtimi dhe operimi. Për vitin 2022 janë realizuar objektivat si: grumbullimi dhe transportimi i mbetjeve urbane dhe tregjeve; Larje dhe dezinfektimi i kontenjereve; Mirëmbajtje të vendgrumbullimeve të mbetjeve gjatë ditës;

- **Autoriteti Kontraktues:** Bashkia Kamëz
- **SPV:** “Eco Cleaning” sh.p.k
- **Vlera e Investimit:** 1.35 miliardë Lek
- **Data e fillimit të kontratës:** 12 Maj 2018
- **Kohëzgjatja e kontratës:** 12 vjet
- **Faza aktuale e projektit:** Ndërtim dhe operim

⁹ Konfirmim zyrtar nga Drejtoria e Përgjithsme e Thesarit

¹⁰ Po aty: <https://financa.gov.al/paketa-e-projektligjit-te-buxhetit-faktik-2021/>.

Grumbullimi i mbetjeve ndërtimore dhe të vëllimshme; Fshirja e rrugëve dhe trotuareve me krahë; Fshirje e rrugëve me makineri; Larje e rrugëve njëherë në ditë; Transportimi dhe depozitimi i mbetjeve në vendet përkatëse të miratuara nga autoritetet përkatëse.

❖ Risqet

Sipas raportimeve, Autoriteti Kontraktues ka mbajtur riskun e qeverisjes, riskun material nga vendimet politike, riskun e ndryshimeve ligjore dhe riskun e rinegocimit, ndërsa partneri privat ka mbajtur riskun e ndërtimit, riskun e operimit (menaxhimi i impiantit, menaxhimi i mbetjeve), riskun e ribalancimit të ekuilibrit financiar dhe riskun e transferimit të aseteve. Ndërkohë risku i forcës madhore, risku i ndërprerjes së kontratës, risku financiar janë ndarë mes të dyja palëve. Autoriteti ka raportuar materializim të riskut të lejeve, pasi nuk nuk është realizuar pajisja me leje mjedisore për ndërtimin e stacionit të transferimit. Koncesionari është në proces gjyqësor me Agjencinë Rajonale Mjedisore përse i përket mosdhënies së lejes mjedisore, si dhe është në proces negocimi me koncesionarin e Landfillit të Sharrës për lidhjen e një marrëveshjeje që të zgjidhë çështjen e marrjes së lejes mjedisore për ndërtimin e stacionit të transferimit.

13. Kontratë Koncesioni/PPP “Menaxhimi dhe zhvillimi teknologjik i prodhimit të fidanëve pyjor/arrorë në fidanishten shtetërore të Cërrikut Elbasan”¹¹

Objekti i kësaj kontrate koncesioni është menaxhimi dhe zhvillimi teknologjik i prodhimit të fidanëve pyjor/arrorë në fidanishten shtetërore të Cërrikut, Elbasan nga ana e shoqërisë koncesionare dhe transferimi i saj shtetit shqiptar në fund të periudhës së koncesionit. Referuar raportimeve dhe konfirmimeve të Autoritetit Kontraktues, gjatë vitit 2022 ky projekt është në fazë operimi, dhe ky projekt ka një progres të ngadaltë bazuar në objektivat e përcaktuara në Planin e Biznesit. Shoqëria Koncesionare ka realizuar investime në makineri dhe investime në mbjellje parcelash me bimë.

- **Autoriteti Kontraktues:** Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
- **SPV:** “Almex Greenwood” sh.p.k
- **Vlera e Investimit:** 49 milionë Lek
- **Data e fillimit të kontratës:** 07 Tetor 2014
- **Kohëzgjatja e kontratës:** 35 vjet
- **Faza aktuale e projektit:** Operim
- Forma:** Propozim i Pakërkuar

❖ Risqet

Ndarja e risqeve është bërë sipas metodës së alokimit të risqeve mbi palën që është më e aftë për t'i menaxhuar, si rrjedhojë risku i ndërtimit, risku i kërkesës, risku operacional, risku financiar i janë alokuar koncesionarit. Ndër këto risqe, risku i forcës madhore është vlerësuar me impakt të lartë për të ndodhur, si dhe gjithashtu raportohet se është materializuar në vitin 2016 për shkak të përmbytjeve, duke penguar kështu realizimin e objektit brenda afateve. Ndërsa risku i veprimeve materiale negative të qeverisë dhe risku i ndryshimeve ligjore janë të ndara mes palëve dhe janë vlerësuar me probabilitet të ulët për të ndodhur. Risku i përfundimit para kohe të kontratës është vlerësuar si riske me probabilitet të mesëm për të ndodhur. Autoriteti ka raportuar se ka probabilitet që të anulohet kontrata koncesionare.

¹¹ Informacion i hartuar në bazën e raportimeve të Autoritetit Kontraktues.

14. Kontratë Koncesioni/PPP “Për shfrytëzimin e burimit uhor Sasaj, Bunec”

Objekti i kësaj kontrate koncesioni është shfrytëzimi nga ana e shoqërisë koncesionare të burimit uhor “Sasaj” në fshtatin Bunec, Komuna Lukovë, Sarandë, nëpërmjet financimit, projektimit, ndërtimit, vënies në punë, administrimit, mirëmbajtjes së veprës si dhe transferimin e tij në përfundim të periudhës së koncesionit tek Autoriteti Kontraktues. Me VKM nr. 775, datë 04.12.2019, është përcaktuar MBZHR, si i vetmi Autoritet Kontraktues përgjegjës për ndjekjen dhe zbatimin e kësaj kontrate koncesionare. Sipas raportimit, ky projekt nuk ka nisur akoma zbatimin pasi nuk është dorëzuar akoma sipërfaqja e tokës tek koncesionari, sipas detyrimeve kontraktuale. Nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është aplikuar në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Sarandë për informacion për statusin juridik të pasurive që preken nga ky koncesion, për të bërë të mundur dorëzimin e sipërfaqes të Koncesionari, me qëllim fillimin e këtij koncesioni. Nga informacioni i ardhur nga Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Sarandë, rezulton se disa pasuri objekt të koncesionit janë në pronësi të personave private, për të cilat konsiderohet i nevojshëm shpronësimi i tokës.

- **Autoriteti Kontraktues:** Ministria e Mjedisit
- **SPV:** “Blue Eye One” sh.p.k
- **Vlera e Investimit:** 503.7 milionë Lek
- **Data e fillimit të kontratës:** 14 Gusht 2014
- **Kohëzgjatja e kontratës:** 20 vjet
- **Faza aktuale e projektit:** Nuk ka nisur zbatimin
- **Forma:** Propozim i Pakërkuar

Sektori i Shëndetësisë¹²

Në sektorin e shëndetësisë janë miratuar 4 kontrata koncesionare/PPP që kanë si Autoritet Kontraktues Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, dhe kanë si qëllim ofrimin e një shërbimi sa më cilësor, më të shpejtë dhe efektiv në lidhje me shëndetin e qytetarëve.

15. Kontratë Koncesioni/PPP “Për shërbime të integruara për ofrimin e setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale, furnizimin me material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, si dhe trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale”

Objekti i kësaj kontrate koncesioni është menaxhimi i qendrës së sterilizimit, ofrimi i instrumenteve kirurgjikale sterile sipas setit të personalizuar, veshjet në sallat kirurgjikale, trajtimi i mbetjeve mjekësore me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale ku do të ofrohet ky shërbim. Projekti shtrihet në të gjitha spitalet universitare, rajonale dhe spitalet bashkiakë. Referuar raportimeve dhe konfirmimit të Autoritetit Kontraktues, gjatë vitit 2022 ky projekt është në fazën e operimit.

- **Autoriteti Kontraktues:** Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
- **SPV:** Sani Service sh.p.k
- **Vlera e Investimit:** 1.5 miliardë Lek
- **Data e fillimit të kontratës:** 10 Dhjetor 2015
- **Kohëzgjatja e kontratës:** 10 vjet
- **Faza aktuale e projektit:** Operim
- **Forma:** Propozim i Kërkuar

¹² Informacioni është raportuar dhe konfirmuar nga ana e Autoritetit Kontraktues.

Ky projekt financohet tërësisht me fonde publike sipas metodës (pay x use) në varësi të numrit të pacientëve të cilët do të duhet të marrin shërbimin.

Gjatë vitit 2022 nga të dhënat e raportuara nga Autoriteti Kontraktues evidentohet se shërbimi i sterilizimit është planifikuar për t'u ofruar për 63,608 ndërhyrje kirurgjikale. Për vitin 2022 është realizuar një shërbim prej 61,450 ndërhyrje kirurgjikale të kompleksiteteve të ndryshme, si dhe 74,642 paketime me avull dhe 3,061 paketime me temperaturë të ulët. E shprehur në terma financiare të dhënat tregojnë se për mbulimin e këtij shërbimi, është planifikuar një shumë prej 1,700,000 lekë me TVSh, nga të cilat janë paguar në total 1,699,974 lekë me TVSh.

❖ **Tabela 7: Pagesat Buxhetore për projektin objekt kontrate “Setet Kirurgjikale”**

Viti	2019		2020		2021		2022	
	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Pagesat Buxhetore (në mijë Lekë)	2,168,827	2,163,282	1,300,700	1,288,269	1,564,982	1,500,924	1,700,000	1,699,974

❖ **Risqet**

Në lidhje me risqet e kontratës tek pala private janë transferuar risku i projektimit, ndërtimit, i operimit dhe performancës, si dhe risku i transferimit të asetëve, ndërsa risku i ndryshimeve ligjore, risku politik dhe risku financiar i janë alokuar palës publike. Ndërkohë janë ndarë mes palëve risku i lejeve dhe licencave, risku i kërkesës, risku i forcës madhore, risku i rinegociimit dhe risku i ndërprerjes së kontratës.

16. Kontrata Koncesionare/PPP “Për paketën e shërbimeve të kontrollit mjekësor bazë për grupmoshat 35-70”

Objekti i kësaj kontrate koncesioni/PPP është ofrimi i paketës së shërbimeve të kontrollit mjekësor bazë për grupmoshat 35-70 vjeç. Në bazë të kësaj kontrate, shoqëria koncesionare ka marrë përsipër të ndërtojë, pajisë me aparaturat mjekësore të nevojshme, operojë dhe menaxhojë 20 laboratore. Ky shërbim përfitohet falas nga të gjithë shtetasit e grupmoshës 35-70 vjeç me qëndrim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë.

Referuar raportimeve dhe konfirmimit të Autoritetit Kontraktor: Për sa i përket detyrimeve kontraktuale, konkretisht aneksit 7 të kontratës koncesionare, “Çështje

financiare”, çmimi i pranuar për njësi (pa TVSH) do të jetë në vlerën 1,537 lekë, duke patur parasysh se vlera minimale e pagueshme nga Autoriteti për shërbimet e ofruara nga Koncesionari do të jetë 730,075,000 lekë (pa TVSH) për çdo vit të plotë. Kjo vlerë ngelet e pandryshueshme pavarësisht faktit nëse numri i analizave vjetore arrin shifrën 475,000 apo jo. Në fund të vitit 2016 është shtuar pika, që në rast se në një vit të plotë të zbatimit të kontratës së Koncesionit kryhen më shumë se 475.000 analiza, vlera financiare e analizave të kryera më tepër se 475.000, të

- **Autoriteti Kontraktues:** Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
- **SPV:** “3P Life Logistic” sh.p.k
- **Vlera e Investimit:** 172 milionë Lek
- **Data e fillimit të kontratës:** 7 Janar 2015
- **Kohëzgjatja e kontratës:** 10 vjet
- **Faza aktuale e projektit:** Operim
- **Forma:** Propozim i Kërkuar

kompensohet me vlerën financiare të analizave të pakryera në vitet e mëparshme të zbatimit të kontratës.

Programi i Kontrollit Shëndetësor Bazë ka mundësuar nëpërmjet kabineteve të tij, që të ketë standardizim të cilësisë së shërbimit të ofruar në të gjithë Shqipërinë. Qytetarët e qendrave shëndetësore urbane dhe rurale marrin të njëjtën cilësi shërbimi. Ky është i pari program që adreson reduktimin e pabarazive në shëndet, të cilat në vendin tonë kanë një ndarje të qartë urbane/rurale. Ky program është mjeti më efektiv për të bërë një screening të faktorëve të rrezikut për sëmundjet kronike, të cilat zënë 90% të barrës së sëmundshmërisë në vend.

❖ **Tabela 8: Numri i Përfituesve të kontrollit mjekësor bazë “Check-Up”**

Viti	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Nr.i Përfituesve	244,420	329,555	316,601	428,891	482,716	101,426	164,982	454,828

❖ **Tabela 9: Pagesat Buxhetore për projektin objekt kontrate “Kontrolli Mjekësor Bazë Check-Up”**

Viti	2018		2019		2020		2021		2022	
	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan ¹³	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Pagesat Buxhetore (në mijë Lekë)	876,083	876,083	876,083	876,083	352,083	322,322	366,090	219,021	876,090	876,083

❖ **Risqet**

Në lidhje me risqet që rrjedhin nga zbatimi i kontratës koncesionare, tek pala private janë transferuar risku i ndërtimit, risku i operimit dhe performancës, risku i transferimit të asetëve, ndërsa risku i ndryshimeve ligjore, risku material nga vendimet politike, risku financiar i janë alokuar palës publike. Ndërkohë janë ndarë mes palëve risku i kërkesës, risku i forcës madhore, risku i rinegociimit, risku i ndërprerjes së kontratës dhe risku i lejeve dhe licencave. Duke qene se gjatë vitit 2020, u materializua risku i forcës madhore si rezultat i pandemisë Covid-19, palët vendosën pezullimin e shërbimit për një periudhë kohe. Ky shërbim rifilloi serisht në Shtator të vitit 2021. Lidhur me adresimin e riskut të kërkesës, Autoriteti Kontraktues ka ndërmarrë iniciativën për ndryshimin e kontratës në lidhje me moshën e përfituesve duke e zgjeruar fashën e mbulimit nga 40-65 vjeç në fashën 35-70 vjeç.

¹³ Plan i ndryshuar.

17. Kontratë Koncesioni/PPP “Për ofrimin e shërbimit të hemodializës”

Objekti i kësaj kontrate koncesioni/PPP është ofrimi nga ana e shoqërisë koncesionare i të gjitha mjeteve, pajisjeve dhe materialeve mjekësore dhe jo-mjekësore për ofrimin e shërbimit të hemodializës pranë spitaleve rajonale Shkodër, Lezhë, Elbasan, Vlorë, Korçë; rehabilitimi i hapësirave ekzistuese dhe ndërtimi i hapësirave të reja; pajisja me poste për kryerjen e hemodializës në të pesë qendrat e sipërmendura, si dhe me pajisje laboratorike për testet mujore laboratorike.

Referuar raportimeve dhe konfirmimit të Autoritetit Kontraktues, gjatë vitit 2022 kjo kontratë është në fazën e operimit. Duke qënë se shërbimi i hemodializës është jetësor për pacientët, Autoriteti Kontraktues nuk ka marrë masa për pezullimin në kuadër të situatës së krijuar nga Pandemia Covid-19. Ecuria e pagesave buxhetore për këtë kontratë koncesioni është si më poshtë:

- **Autoriteti Kontraktues:** Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
- **SPV:** “Dia Vita” sh.p.k
- **Vlera e Investimit:** 1,17 miliardë Lek
- **Data e fillimit të kontratës:** 10 Shkurt 2016
- **Kohëzgjatja e kontratës:** 10 vjet
- **Faza aktuale e projektit:** Operim
- **Forma:** Propozim i Kërkuar

❖ Tabela 10: Pagesat Buxhetore për projektin “Shërbimi hemodializës”

Viti	2018		2019		2020		2021		2022	
	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Pagesat Buxhetore (në mijë)	742,849	738,911	807,448	804,388	733,300	733,203	754,000	747,195	835,000	802,582

Autoriteti Kontraktor, gjatë vitit 2022, ka raportuar: Bazuar në kontratën koncesionare evidentohet se shërbimi i dializës është planifikuar për t’u ofruar për 450 pacientë nga të cilët mesatarisht 432 pacientët kanë marrë këtë shërbim. Ndërsa për sa i përket numrit të seancave të shërbimit të dializës nga të dhënat evidentojmë se janë ofruar 63,279 seanca dialize nga 70,200 seanca që ishte parashikuar si projekcion për vitin 2022. E shprehur në terma financiare të dhënat tregojnë se për mbulimin e këtij shërbimi ishte planifikuar një shumë prej 835,000,000 lekësh me TVSH, nga të cilat janë paguar në total 802,583,921 lekë me TVSH. Nga raporti del se ofrimi i këtij shërbimi me Koncesion ka sjellë një sërë përfitimesh për qytetarët shqiptarë. Duhet theksuar se para vitit 2016, 65% e shërbimit ofrohej në spitalet jopublike dhe vetëm 35% e shërbimit në spitalet publike me një tarifë 90 Euro për seancë, ku shteti paguante edhe transportin. Numri i pacientëve përfitues të paketës së dializës në spitalet publike, jo publike dhe falë partneritetit publik privat të hemodializës është rreth 1,300 pacientë.

❖ Tabela 11: Numri i përfituesve dhe seancave të realizuara

Viti	2019		2020		2021		2022	
	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Nr. Përfituesve (përfitues /muaj)	370	398	394	420	420	411	450	432
Nr.Seancave	57,720	57,809	61,464	62,020	65,520	60,719	70,200	63,279

❖ Risqet

Kjo kontratë koncesioni ka alokuar riskun sipas parimit të palës që menaxhon më mirë. Tek pala private janë alokuar risku i ndërtimit, risku i operimit dhe performancës dhe risku i transferimit të

aseteve, ndërsa palës publike i janë alokuar risku financiar, risku i ndryshimeve ligjore, risku material nga vendimet politike dhe riskun e ribalancimit të ekuilibrit financiar. Ndërkohë janë ndarë mes palëve risku i rinegociimit, risku i përfundimit të kontratës, risku i lejeve dhe licencave, forca madhore dhe risku i kërkesës. Gjithashtu, pavarësisht materializimit të riskut të forcës madhore, si rezultat i Pandemisë Covid-19, kjo kontratë koncesioni ka vijuar normalisht ofrimin e shërbimit të hemodializes.

18. Kontratë Koncesioni/PPP “Për ofrimin e shërbimeve laboratorike mjekësore”

Objekti i kësaj kontrate koncesioni është financimi, projektimi, rinovimi, pajisja, riorganizimi dhe funksionimi i shoqërisë koncesionare për ofrimin e shërbimit laboratorik të spitaleve universitare, rajonale, dhe atyre bashkiake. Kjo kontratë ka nisur funksionimin e saj më datë 2 Nëntor 2020 në Qendrën Universitare Spitalore “Nënë Tereza”. Referuar raportimeve dhe konfirmimit të Autoritetit Kontraktues, gjatë vitit 2022 ka filluar shërbimi në të gjitha spitalet universitare në vend, në spitalet rajonale të Durrësit, Elbasanit, Shkodrës, Fierit, Beratit, Korçës, Lezhës dhe spitalin bashkiak Lushnjë.

- **Autoriteti Kontraktues:** Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
- **SPV:** “Labopharma” sh.p.k
- **Vlera e Investimit:** 1,31 miliardë Lek
- **Data e fillimit të kontratës:** 10 Prill 2019
- **Kohëzgjatja e kontratës:** 10 vjet
- **Faza aktuale e projektit:** Operim
- **Forma:** Propozim i Kërkuar

Gjatë vitit 2022 nga të dhënat e raportuara nga Autoriteti Kontraktues:

Shërbimi i laboratorëve është ofruar për 18 Spitale Referuese. E shprehur në terma financiare të dhënat tregojnë se për mbulimin e këtij shërbimi ishte planifikuar një shumë prej 1,639,002,000 lekësh me TVSH, nga të cilat janë paguar në total 1,612,914,000 lekë me TVSH.

❖ *Tabela 12: Pagesat Buxhetore për projektin “Për ofrimin e shërbimeve laboratorike mjekësore”*

Viti	2020		2021		2022	
	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
<i>Pagesat Buxhetore (në mijë Lekë)</i>	80,0000	30,670	1,137,845	1,103,199	1,639,002	1,612,914

❖ **Risqet**

Në lidhje me risqet që rrjedhin nga zbatimi i kontratës koncesionare, tek pala private janë transferuar risku i ndërtimit, risku i operimit dhe performancës, risku i transferimit të aseteve, ndërsa risku i ndryshimeve ligjore, risku material nga vendimet politike, risku financiar i janë alokuar palës publike. Ndërkohë janë ndarë mes palëve risku i kërkesës, risku i forcës madhore, risku i rinegociimit, risku i ndërprerjes së kontratës dhe risku i lejeve dhe licencave.

Sektori i Energjitikës¹⁴

Gjatë viteve 2005-2013, në kuadër të privatizimit të HEC-eve vendore një numër hidrocentralësh të vegjël u privatizuan dhe disa të tjerë iu dhanë kompanive të huaja dhe vendase përmes kontratave koncesionare të tipit ROT, BOT dhe BOO. Qëllimi i këtyre kontratave ishte rehabilitimin i HEC-eve ekzistuese, operimi i tyre dhe më pas transferimi tek shteti. Sipas raportimeve periudike të përcjella dhe të konfirmuara nga Autoriteti Kontraktues, aktualisht janë 183 kontrata koncesionare në fushën e hidroenergjisë. Dy kontratat me të mëdha koncesionare të miratuara janë “Hidrocentrali i Ashtës” dhe “Kaskada e hidrocentralit të Devollit”. Duke qënë se sektori i hidroenergjisë përmban një portofol të madh të kontratave koncesionare, në këtë raport për vitin 2022 është paraqitur informacion për kontratat për të cilat informacioni i raportuar është më i plotë nga Autoriteti Kontraktues. Në vijim synohet paraqitja e informacionit për të gjitha kontratat e koncesionit në këtë sektor.

19. Kontrata Koncesionare/PPP “Për projektimin, financimin, ndërtimin, pronësinë, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Hidrocentralit Ashta”

Objekti i kontratës së koncesionit/PPP është projektimi, financimi, ndërtimi, marrja në pronësi, shfrytëzimi, mirëmbajtja dhe transferimi i Hidrocentralit të Ashtës. Kontrata koncesionare ka parashikuar ndërtimin e 2 hidrocentraleve dhe konkretisht Ashta 1 dhe Ashta 2.

Referuar raportimeve dhe Konfirmimit të Autoritetit Kontraktues, gjatë vitit 2022 ky projekt ka qënë në fazën e operimit që prej fundit të vitit 2013. Realizimi i investimit të këtij projekti është finalizuar brenda afateve kohore të parashikuara në marrëveshjen mes palëve, përkatësisht ndërtimi është realizuar në

periudhën kohore 2010-2012. Prodhimi i energjisë elektrike nga HEC Ashta 1,2, bëhet me planifikim dhe sipas regjimit të shkarkimit nga KESH sh.a. Për këtë projekt është nënshkruar fillimisht me KESH më pas me OSHEE, një marrëveshje për shitjen e energjisë elektrike. Kjo marrëveshje është nënshkruar në 2016, pas ndryshimeve ligjore dhe nënligjore në sektorin e energjisë elektrike, ku detyrimi për blerjen e energjisë elektrike nga prodhuesit me përparësi kaloi nga KESH sh.a. tek OSHEE sh.a. (pika G e kësaj marrëveshje). Kjo marrëveshje vjen në vijim të marrëveshjes së nënshkruar më datë 28.03.2013 (pika F), dhe do të jetë e vlefshme për një periudhë 15 vjeçare nga momenti i nënshkrimit (28.03.2028) (pika E).

Në bazë të marrëveshjes koncesionare, energjia e prodhuar nga Hidrocentral Ashta 1, 2 nuk duhet të jetë më pak se 165,000,000 KWH/vit, ndërkohë ecuria e sasisë së energjisë së prodhuar nga shoqëria koncesionare ndër vite është si më poshtë:

- **Autoriteti Kontraktues:** METE (sot MIE)
- **SPV:** “Energji Ashta” sh.p.k
- **Vlera e Investimit:** 19,5 miliardë Lek
- **Data e fillimit të kontratës:** 22 Tetor 2008
- **Kohëzgjatja e kontratës:** 35 vjet
- **Faza aktuale e projektit:** Operim
- **Forma:** Propozim i pakërkuar

¹⁴ Informacioni për ecurinë e kontratave koncesionare/PPP të sektorit të energjitikës është hartuar sipas raportimeve të Autoritetit Kontraktues bazuar në informacionin e konfirmuar të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Ujore (AKBN).

❖ *Tabela 13: Sasia e energjisë së prodhuar (në KWh/Vit)*

Viti	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Sasia e energjisë	235,604,000	276,604,000	174,526,000	298,107,000	191,495,000	187,222,000	295,245,000	236,276,115

❖ **Risqet**

Në lidhje me risqet që rrjedhin nga zbatimi i kontratës koncesionare, tek pala private janë transferuar: risku i ndërtimit, risku financiar, risku i operimit dhe performancës dhe risku i transferimit të aseteve, ndërsa risku i qeverisjes, risku i ndryshimeve ligjore dhe risku material nga vendimet politike i janë alokuar palës publike. Ndërkohë janë ndarë mes palëve risku i forcës madhore, risku i rinegociimit dhe risku i ndërprerjes së kontratës. Gjatë zbatimit të kontratës nuk ka patur materializim të risqeve, dhe aktualisht Autoriteti përgjegjës për monitorimin e kësaj kontrate ka raportuar probabilitetet të ulët të ndodhjes së risqeve.

20. Kontrata Koncesionare/PPP “Për projektimin financimin, ndërtimin, marrjen në pronësi, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e projektit të hidrocentralit në lumin Devoll”

Objekti i kësaj kontrate koncesioni/PPP është projektimi financimi, ndërtimi, marrja në pronësi, shfrytëzimi, mirëmbajtja dhe transferimi i projektit të hidrocentralit në lumin Devoll. Ky projekt synon ndërtimin, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin në fund tek Autoriteti Kontraktues të hidrocentraleve HEC Banjë, HEC Moglicë dhe HEC Kokël, ku për HEC Kokël Shtesa e III-të e Kontratës së Koncesionit, miratuar me ligjin Nr. 7/2015, datë 12.02.2015 i ka dhënë të drejtën Koncesionarit të vendosë sipas diskrecionit të tij të plotë, brenda një afati prej 10 vitesh nga përfundimi i HEC Moglicë, nëse do e ndërtojë HEC-in Kokël (i cili është HEC-i i mesit në kaskadën e lumit Devoll).

- **Autoriteti Kontraktues:** METE (sot MIE)
- **SPV:** “Devoll Hydropower” sh.a
- **Vlera e Investimit:** 590 milionë Euro
- **Data e fillimit të kontratës:** 17 Mars 2009
- **Kohëzgjatja e kontratës:** 35 vjet
- **Faza aktuale e projektit:** Operim
- **Forma:** Propozim i Pakërkuar

Në këtë kontratë koncesioni është bërë një shtesë më datë 18.12.2014 “Për projektimin dhe ndërtimin e infrastrukturës zëvendësuese të Moglicës”, me anën e së cilës koncesionari ka marrë përsipër të projektojë, ndërtojë infrastrukturën zëvendësuese kundrejt një kompensimi nga buxheti i shtetit. Ndërtimi i infrastrukturës zëvendësuese është realizuar plotësisht dhe pagesat buxhetore për këtë shtesë kanë përfunduar në Shtator 2019. Gjatë vitit 2019-2020 është realizuar 100% e vlerës totale të investimit.

Referuar raportimeve dhe konfirmimit të Autoritetit Kontraktues gjatë vitit 2022 ky projekt ka qenë në fazën e prodhimit të energjisë të dy HEC-et. Referuar kontratës së koncesionit/PPP shteti shqiptar nuk e ka detyrim blerjen e energjisë elektrike të prodhuar nga shoqëria koncesionare Devoll Hydropower sh.a.

Në bazë të marrëveshjes koncesionare, energjia e prodhuar nga Hec Banja nuk duhet të jetë më pak se 255,000,000 KWH/vit. Në bazë të marrëveshjes koncesionare, energjia e prodhuar nga HEC Moglica nuk duhet të jetë më pak se 450,000,000 KWh/vit.

Ecuria e sasisë së energjisë së prodhuar nga dy Hec-et që nga viti i fillimit të prodhimit është si më poshtë:

❖ *Tabela 14: Sasia e energjisë së prodhuar (në KWh/Vit)*

Viti	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Benje	140,866,000	292,561,000	153,357,000	134,044,000	258,712,000	167,595.76
Moglice	-	-	-	160,110,000	424,280,000	320,980.79

❖ **Risqet**

Autoriteti ka raportuar në lidhje me risqet e kontratës sipas formatit të përcaktuar, duke specifikuar përcaktimin e palës që merr përsipër riskun, impaktin fiskal nëse është materializuar, probabilitetin e ndodhjes në të ardhmen dhe impaktin e pritshëm nëse ndodh. Në lidhje me risqet që rrjedhin nga zbatimi i kontratës koncesionare, tek pala private janë transferuar risku i ndërtimit, risku financiar, risku i operimit dhe performancës dhe risku i rinegocimit, ndërsa risku i qeverisjes, risku i ndryshimeve ligjore dhe risku material nga vendimet politike i janë alokuar palës publike, të cilat Autoriteti i ka kategorizuar si risqe me probabilitet të ulët për tu materializuar në të ardhmen. Ndërkohë është ndarë mes palëve risku i ndërprerjes së kontratës.

21. Kontratë koncesioni/PPP “Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentraleve Prellë 1 dhe Prellë 2”

Objekti i kësaj kontrate koncesioni është financimi, projektimi, ndërtimi, vënia në punë, administrimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve ‘Prellë 1’ dhe ‘Prellë 2’, si dhe transferimi nga shoqëria koncesionare tek Autoriteti Kontraktues. Kjo kontratë koncesioni gjatë vitit 2022 ka qenë në fazën e zbatimit që prej vitit 2017. Deri në fund të vitit 2016, realizimi i investimeve nga ana e shoqërisë koncesionare ka qenë në masën 55% të vlerës totale të parashikuar në kontratë. Në bazë të marrëveshjes koncesionare, energjia e prodhuar nga hidrocentralet nuk duhet të jetë më pak se 47,499,430 kWh/vit, ndërkohë ecuria e sasisë së energjisë së prodhuar nga shoqëria koncesionare ndër vite është si më poshtë:

- **Autoriteti Kontraktues:** METE (sot MIE)
- **SPV:** Prell Energy sh.p.k
- **Vlera e Investimit:** 1.51 miliardë Lek
- **Data e fillimit të kontratës:** 4 Gusht 2008
- **Kohëzgjatja e kontratës:** 35 vjet
- **Faza aktuale e projektit:** Operim
- **Forma:** Propozim i pakërkuar

❖ *Tabela 15: Sasia e energjisë së prodhuar (në kWh/Vit)*

Viti	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Sasia e energjisë	24,794,958	41,956,588	31,596,853	22,279,817.36	43,066,375	35,106,172

❖ **Risqet**

Lidhur me risqet e kësaj kontrate Autoriteti Kontraktues në raportimet e tij të dërguara periodikisht pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, nuk ka përcjellë informacion apo evidentuar për materializimin e ndonjë risku të mundshëm. Megjithatë Autoriteti Kontraktues ka vlerësuar pozitivisht ecurinë e kësaj kontrate koncesioni në përputhje me detyrimet kontraktuale.

22. Kontratë koncesioni/PPP “Ndërtim, shfrytëzim dhe transferim të Hidrocentraleve Lura 1, 2 dhe 3”

Objekti i kontratës së koncesionit është financimi, projektimi, ndërtimi, vënia në punë, administrimi, mirëmbajtja, prodhimi dhe shitja e energjisë elektrike në hidrocentralet Lura 1, Lura 2, Lura 3, si dhe transferimi tek Autoriteti Kontraktues në përfundim të kohëzgjatjes së kontratës. Referuar raportimeve dhe konfirmimit të Autoritetit Kontraktues, gjatë vitit 2022 ky projekt ka qenë në zbatim. Pas përfundimit të punimeve ndërtimore në vitin 2012 sipas parashikimeve kontraktuale, në vitin 2013 shoqëria koncesionare vendosi në funksionim hidrocentralin për prodhimin e energjisë elektrike.

Në bazë të marrëveshjes koncesionare, energjia e prodhuar nga hidrocentralet nuk duhet të jetë më pak se 53,308,264 kWh/vit, ndërkohë ecuria e sasisë së energjisë së prodhuar nga shoqëria koncesionare ndër vite është si më poshtë:

❖ *Tabela 16: Sasia e energjisë së prodhuar (në kWh/Vit)*

Viti	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Sasia e energjisë	39,960,936	49,252,118	29,182,802	48,079,191	34,265,264	28,275,308	48,247,511	36,993,079

❖ *Risqet*

Lidhur me risqet e kësaj kontrate Autoriteti Kontraktues në raportimet e tij të dërguara periodikisht pranë Ministrisë së Financave, nuk ka përcjellë informacion apo evidentuar për materializimin e ndonjë risku të mundshëm. Megjithatë Autoriteti Kontraktues ka vlerësuar pozitivisht ecurinë e kësaj kontrate koncesioni në përputhje me detyrimet kontraktuale.

23. Kontratë Koncesioni/PPP “Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Bistrica 3 dhe 4”

Objekti i kësaj kontrate koncesioni është financimi, projektimi, ndërtimi, vënia në punë, administrimi, mirëmbajtja e hidrocentraleve Bistrica 3 dhe 4 mbi lumin Bistricë, fshati Krane, rrethi Sarandë. Në fund të periudhës koncesionare objekti do të transferohet tek Autoriteti Kontraktues.

Referuar raportimeve dhe konfirmimit të Autoritetit Kontraktues, gjatë vitit 2022 vetëm hidrocentrali Bistrica 3 ka qenë në fazë shfrytëzimi (prodhimi energjie elektrike) që prej vitit 2016, ndërsa hidrocentrali Bistrica 4 nuk është ndërtuar ende. Deri në vitin 2015, nga ana e shoqërisë koncesionare janë realizuar 57% e vlerës totale të investimit. Në bazë të marrëveshjes koncesionare, energjia e prodhuar nga hidrocentral

- **Autoriteti Kontraktues:** METE (sot MIE)
- **SPV:** “Erdat” Lura sh.p.k
- **Vlera e Investimit:** 1.3 miliardë Lek
- **Data e fillimit të kontratës:** 09 Maj 2008
- **Kohëzgjatja e kontratës:** 35 vjet
- **Faza aktuale e projektit:** Operim
- **Forma:** Propozim i pakërkuar

- **Autoriteti Kontraktues:** METE (sot MIE)
- **SPV:** ‘Bistrica 3’ sh.p.k
- **Vlera e Investimit:** 756.4 milionë Lek
- **Data e fillimit të kontratës:** 19 Maj 2008
- **Kohëzgjatja e kontratës:** 35 vjet
- **Faza aktuale e projektit:** Operim
- **Forma:** Propozim i pakërkuar

Bistrica 3 duhet të jetë 23,652,000 kWh/vit, ndërsa hidrocentral Bistrica 4 duhet të prodhojë 23,652,000 kWh/vit. Ndërkohë ecuria e sasisë së energjisë së prodhuar nga hidrocentral Bistrica 3 ndër vite është si më poshtë:

❖ **Tabela 17: Sasia e energjisë së prodhuar (në kWh/Vit)**

Viti	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Sasia e energjisë	10,104,204	8,346,166	9,357,579	8,081,232	7,281,864	9,061,380	8,467,560

❖ Risqet

Lidhur me risqet e kësaj kontrate Autoriteti Kontraktues në raportimet e tij të dërguara periodikisht pranë Ministrisë së Financave, nuk ka përcjellë informacion apo evidentuar për materializimin e ndonjë risku të mundshëm. Megjithatë Autoriteti Kontraktues ka vlerësuar pozitivisht ecurinë e kësaj kontrate koncesioni në përputhje me detyrimet kontraktuale.

24. Kontratë Koncesioni/PPP “Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Ballenjë”

Objekti i kësaj kontrate koncesioni është financimi, projektimi, ndërtimi, vënia në punë, administrimi, mirëmbajtja e hidrocentralit dhe transferimi i tij nga Koncesionari tek Autoriteti Kontraktues.

Referuar raportimeve dhe konfirmimit të Autoritetit Kontraktues, gjatë vitit 2022 kjo kontratë ka qenë në fazë zbatimi. Hidrocentrali është në fazë prodhimi energjie që nga viti 2016, pas përfundimit të investimeve nga ana e shoqërisë koncesionare.

Në bazë të marrëveshjes koncesionare, energjia e prodhuar nga hidrocentralet duhet të jetë mesatarisht 4,197,824 kWh/vit, ndërkohë ecuria e sasisë së energjisë së prodhuar nga shoqëria koncesionare ndër vite është si më poshtë:

❖ **Tabela 18: Sasia e energjisë së prodhuar (në kWh/Vit)**

Viti	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Sasia e energjisë	1,943,354	4,025,458	3,618,526	2,380,560	3,943,401	2,712,549

❖ Risqet

Lidhur me risqet e kësaj kontrate Autoriteti Kontraktues në raportimet e tij të dërguara periodikisht pranë Ministrisë së Financave, nuk ka përcjellë informacion apo evidentuar për materializimin e ndonjë risku të mundshëm. Megjithatë Autoriteti Kontraktues ka vlerësuar pozitivisht ecurinë e kësaj kontrate koncesioni në përputhje me detyrimet kontraktuale.

- **Autoriteti Kontraktues:** METE (sot MIE)
- **SPV:** “Ballenja Power Martanesh” sh.p.k
- **Vlera e Investimit:** 138.3 milionë Lek
- **Data e fillimit të kontratës:** 03 Shtator 2013
- **Kohëzgjatja e kontratës:** 35 vjet
- **Faza aktuale e projektit:** Operim
- **Forma:** Propozim i pakërkuar

25. Kontratë Koncesioni/PPP “Kontratë për ndërtimin, shfrytëzimin dhe transferimin e hidrocentralit Bishnica 1,2”

Objekti i kësaj kontrate koncesioni është financimi, projektimi, ndërtimi, vënia në punë, administrimi, mirëmbajtja e hidrocentraleve Bishnica 1 dhe Bishnica 2 dhe transferimi i tij nga Koncesionari tek Autoriteti Kontraktues. Referuar raportimeve dhe konfirmimit të Autoritetit Kontraktues, gjatë vitit 2022 kjo kontratë ka qenë në fazë zbatimi. Hidrocentrali ndodhet në fazën e shfrytëzimit (prodhimit të energjisë elektrike) që prej vitit 2010. Deri në vitin 2012, nga ana e shoqërisë koncesionare është realizuar vlera totale e investimit.

- **Autoriteti Kontraktues:** METE(sot MIE)
- **SPV:** “Bishnica 1,2” sh.p.k
- **Vlera e Investimit:** 250 milionë Lek
- **Data e fillimit të kontratës:** 06 Tetor 2008
- **Kohëzgjatja e kontratës:** 35 vjet
- **Faza aktuale e projektit:** Operim
- **Forma:** Propozim i pakërkuar

Në bazë të marrëveshjes koncesionare, energjia e prodhuar nga hidrocentralet duhet të jetë 12,910,000 kWh/vit, ndërkohë ecuria e sasisë së energjisë së prodhuar nga shoqëria koncesionare ndër vite është si më poshtë:

❖ Tabela 19: Sasia e energjisë së prodhuar (në kWh/Vit)

Viti	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Sasia e energjisë	10,608,056	11,256,592	12,677,681	8,165,089	10,739,180	9,044,954	7,751,171	11,845,233	9,307,210

❖ Risqet

Lidhur me risqet e kësaj kontrate Autoriteti Kontraktues në raportimet e tij të dërguara periodikisht pranë Ministrisë së Financave, nuk ka përcjellë informacion apo evidentuar për materializimin e ndonjë risku të mundshëm. Megjithatë Autoriteti Kontraktues ka vlerësuar pozitivisht ecurinë e kësaj kontrate koncesioni në përputhje me detyrimet kontraktuale.

26. Kontratë Koncesioni/PPP “Kontratë për ndërtimin,shfrytëzimin dhe transferimin e hidrocentraleve Çekrezë 1 dhe Çekrezë 2”

Objekti i kësaj kontrate koncesioni është financimi, projektimi, ndërtimi, vënia në punë, administrimi, mirëmbajtja e hidrocentraleve si dhe transferimi i tij nga Koncesionari tek Autoriteti Kontraktues. Referuar raportimeve dhe konfirmimit të Autoritetit Kontraktues, gjatë vitit 2022 kjo kontratë ka qenë në fazë zbatimi. Hidrocentrali ndodhet në fazën e shfrytëzimit (prodhimit të energjisë elektrike) që prej vitit 2014.

- **Autoriteti Kontraktues:** METE(sot MIE)
- **SPV:** “Zall Herr Energji 2011” sh.p.k
- **Vlera e Investimit:** 123.8 milionë Lek
- **Data e fillimit të kontratës:** 27 Dhjetor 2011
- **Kohëzgjatja e kontratës:** 35 vjet
- **Faza aktuale e projektit:** Operim
- **Forma:** Pronozim i Pakërkuar

Në bazë të marrëveshjes koncesionare, energjia e prodhuar nga hidrocentralet duhet të jetë 2,667,137 kWh/vit, ndërkohë ecuria e sasisë së energjisë së prodhuar nga shoqëria koncesionare ndër vite është si më poshtë:

❖ *Tabela 20: Sasia e energjisë së prodhuar (në kWh/Vit)*

Viti	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Sasia e energjisë	4,283,160	12,314,097	4,223,727	4,259,037	4,280,935	4,305,772.00	4,329,466	3,784,990

❖ **Risqet**

Lidhur me risqet e kësaj kontrate Autoriteti Kontraktues në raportimet e tij të dërguara periodikisht pranë Ministrisë së Financave, nuk ka përcjellë informacion apo evidentuar për materializimin e ndonjë risku të mundshëm. Megjithatë Autoriteti Kontraktues ka vlerësuar pozitivisht ecurinë e kësaj kontrate koncesioni në përputhje me detyrimet kontraktuale.

27. Kontratë Koncesioni/PPP “Ndërtimi, operimi, mirëmbajtja dhe transferimi i hidrocentraleve të kaskadës së lumit Dardhë”

Objekti i kësaj kontrate koncesioni është financimi, projektimi, ndërtimi, vënia në punë, administrimi, mirëmbajtja e hidrocentraleve dhe transferimi i tij nga Koncesionari tek Autoriteti Kontraktues. Referuar raportimeve dhe konfirmimit të Autoritetit Kontraktues, gjatë vitit 2022 kjo kontratë ka qenë në fazë zbatimi. Hidrocentrali ndodhet në fazën e shfrytëzimit (prodhimit të energjisë elektrike) që prej vitit 2012.

- **Autoriteti Kontraktues:** METE(sot MIE)
- **SPV:** “Wenerg” sh.a.
- **Vlera e Investimit:** 907,9 milionë Lek
- **Data e fillimit të kontratës:** 18 Gusht 2009
- **Kohëzgjatja e kontratës:** 35 vjet
- **Faza aktuale e projektit:** Operim
- **Forma:** Propozim i Pakërkuar

Në bazë të marrëveshjes koncesionare, energjia e prodhuar nga hidrocentralet duhet të jetë 21,690,000 kWh/vit, ndërkohë ecuria e sasisë së energjisë së prodhuar nga shoqëria koncesionare ndër vite është si më poshtë:

❖ *Tabela 21: Sasia e energjisë së prodhuar (në kWh/Vit)*

Viti	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Sasia e energjisë	14,967,741	9,293,436	13,207,710	11,328,690	9,809,794	8,838,463	7,588,643	11,872,459	11,487,845

❖ **Risqet**

Lidhur me risqet e kësaj kontrate Autoriteti Kontraktues në raportimet e tij të dërguara periodikisht pranë Ministrisë së Financave, nuk ka përcjellë informacion apo evidentuar për materializimin e ndonjë risku të mundshëm. Megjithatë Autoriteti Kontraktues ka vlerësuar pozitivisht ecurinë e kësaj kontrate koncesioni në përputhje me detyrimet kontraktuale.

28. Kontratë koncesioni/PPP “Kontratë për ndërtimin, shfrytëzimin dhe transferimin e hidrocentralit Denas”

Objekti i kësaj kontrate koncesioni është financimi, projektimi, ndërtimi, vënia në punë, administrimi, mirëmbajtja e hidrocentralit dhe transferimi i tij nga Koncesionari tek Autoriteti Kontraktues në përfundim të kontratës koncesionare. Referuar raportimeve dhe konfirmimit të Autoritetit Kontraktues, gjatë vitit 2022 kjo kontratë ka qenë në fazë zbatimi. Hidrocentrali ndodhet në fazën e shfrytëzimit (prodhimit të energjisë elektrike) që prej vitit 2018.

Referuar raportimeve dhe konfirmimit të Autoritetit Kontraktues, ka përfunduar pjesa ndërtimore dhe projekti është në fazën e mirëmbajtjes. Kjo kontratë është me mbështetje buxhetore, dhe pagesat realizohen pas përfundimit të objekteve dhe marrjes në dorëzim të tyre nga ana e Autoritetit Kontraktues..

Referuar raportimit të Autoritetit Kontraktues për llogari të vitin 2022 janë bërë total tre pagesa, ku përfshihen 2 këstet të kostos direkte të investimit (kësti I dhe kësti II) dhe kësti I i mirëmbajtjes si më poshte:

Kësti I	395,074,388.49
Kësti II	377,839,968.10
Mirëmbajtja kësti I	61,902.477.36
Total	834,816,833.95

❖ Risqet

Në lidhje me risqet e parashikuara në këtë kontratë koncesioni, palës private i janë alokuar risku i ndërtimit, risku i operimit dhe performancës, risku i ndryshimeve ligjore, ndërsa palës publike i janë alokuar risku i trojeve dhe risku material nga vendimet politike. Ndërkohë risqet e ndara mes palëve janë risku financiar, risku i ndërprerjes së kontratës dhe risku i forcës madhore. Nga ana e Autoritetit probabiliteti i materializimit të risqeve është vlerësuar i ulët në të mesëm.

111. Kontratë Koncesioni/PPP “Për përmirësimin e infrastrukturës Arsimore në Bashkinë Tiranë –Loti 4” me nr. 4907 Rep., dhe Nr. 1874 Kol., datë 08.09.2020.¹⁷

¹⁷ Informacion i hartuar në bazën e raportimeve të Autoritetit Kontraktues

Objekti i kësaj kontrate koncesioni është projektimi, financimi, ndërtimi, paisja me mjete shkollore si dhe mirëmbajtja gjatë kohëzgjatjes së koncesionit për 4 objekte arsimore (shkolla të reja), sipas tipologjisë të përshkruar në kontratë, me vendodhje në Zonën 1, Tiranë. Kjo kontratë ka të parashikuar ndërtimin e 2 shkollave 9-vjeçare dhe 2 shkollave të arsimit të mesëm të cilat në fund të periudhës së koncesionit do të transferohen Bashkisë Tiranë. Kjo kontratë synon të përmirësojë infrastrukturën arsimore në Tiranë duke ndërtuar shkolla të reja në mënyrë që t'u jepet një zgjidhje përfundimtare problemeve me të cilat përballet sistemi arsimor në Tiranë, si zhvillimi i mësimin me dy turne, mbipopullimi i shkollave dhe vështirësitë e aksesit në shkollë.

- **Autoriteti Kontraktues:** Bashkia Tiranë dhe Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
- **SPV:** Shoqëria Tirana 4 sh.p.k
- **Vlera e Investimit:** 2.08 miliardë Lek
- **Data e fillimit të kontratës:** 08 Shtator 2020
- **Kohëzgjatja e kontratës:** 7 vjet
- **Faza aktuale e projektit:** Operim

Në lidhje me vlerën e investimit raportohet se në total për vitin 2022 janë realizuar 289,358,466 lek investime.

❖ Risqet

Në lidhje me risqet e parashikuara në këtë kontratë koncesioni, palës private i janë alokuar risku i ndërtimit, risku i operimit dhe performancës, risku i ndryshimeve ligjore, ndërsa palës publike i janë alokuar risku i trojeve dhe risku material nga vendimet politike. Ndërkohë risqet e ndara mes palëve janë risku financiar, risku i ndërprerjes së kontratës dhe risku i forcës madhore.

112. Kontratë Koncesioni/PPP “Për dhënien me koncesion të aktivitetit të Regjistrimit të Barrëve Siguruese”

Objekti i kësaj kontrate koncesioni/PPP është ofrimi i shërbimit të Regjistrimit të Barreve Siguruese nga shoqëria koncesionare, i cili përfshin: regjistrimin e barreve siguruese, kërkim informacioni, ndryshim i regjistrimit (zgjatje të regjistrimit, fshirje të regjistrimit, reregjistrim i një regjistrimi që ka përfunduar apo është fshirë, transferim i të drejtës së barrëmarrësit dhe barrëdhënësit, shtim dhe fshirje e një barrëdhënësi apo barrëmarrësi, shtim dhe fshirje kolaterali etj.). Gjatë vitit 2022 kjo kontratë ka qenë në fazën e operimit.

- **Autoriteti Kontraktues:** Ministria e Financave dhe Ekonomisë
- **SPV:** Regjistri i Barreve Siguruese sh.p.k
- **Vlera e Investimit:** 35.7 milionë Lekë riinvestim 7.1 milionë Lekë
- **Data e fillimit të kontratës:** 14 Prill 2009
- **Kohëzgjatja e kontratës:** 20 vjet
- **Faza aktuale e projektit:** Operim

Ky projekt nuk është me mbështetje buxhetore, një pjesë e konsiderueshme e regjistrimeve të barreve siguruese në Regjistrin e Barreve Siguruese kryhen nga institucionet mikrofinanciare. Ky regjistër ka kryer funksionin e tij në shërbim dhe bashkëpunim me institucionet financiare dhe mikrofinanciare, banka të nivelit të dytë, studio ligjore dhe noteriale si dhe drejtorite rajonale të shërbimit të transportit rrugor në të gjithë vendin.

Shoqëria koncesionare gjatë vitit 2022 ka realizuar investime në drejtim të blerjes së pajisjeve dhe programeve të reja për përmirësimin e aktivitetit dhe sigurinë e Regjistrimit, si dhe gjithashtu ka kryer mirëmbajtjen e sistemit të Regjistrimit.

Sipas raportimit të shoqërisë koncesionare gjatë vitit 2022, janë kryer 186,469 transaksione që konsistojnë në regjistrim të barreve siguruese kërkim informacioni dhe ndryshim informacioni.

❖ Risqet

Në lidhje me risqet e kësaj kontrate koncesioni, risqet e parashikuara në kontratë dhe të alokuara tek koncesionari janë risku i ndertimit, operimit dhe performancës, dhe risku i transferimit të asetëve. Ndërkohë risqet e alokuara autoritetit kontraktues janë risku i ribalancimit të ekuilibrit financiar, risku material nga vendimet politike, risku i ndryshimeve ligjore. Risqet e ndara mes të dyja palëve janë risku i rinegocimit, risku i ndërprerjes së kontrates dhe forca madhore, risku i kursit të kembimit.

113. Kontratë Koncesioni/PPP “Për dhënien me koncesion të aktivitetit të prodhimit të kripës në Nartë, Vlorë”

Objekti i kësaj kontrate koncesioni është kryerja nga shoqëria koncesionare e rehabilitimit, administrimit, mirëmbajtjes e aktivitetit të prodhimit të kripës, si dhe transferim i të gjitha asetëve të luajtshme e të paluajtshme, në përfundim të kontratës.

Gjatë vitit 2022 kjo kontratë ka qenë në fazën e operimit. Shoqëria koncesionare ka vënë në punë Fabrikën e përpunimit të kripës në Shkurt 2011. Tarifa koncesionare është paguar rregullisht për çdo vit financiar sipas afateve të parashikuara në kontratën e koncesionit.

Deri në fund të vitit 2022 sipas raportimit, janë realizuar rreth 29,302,816 Lekë investim. Nga ana e shoqërisë koncesionare kryhet procedura e kontrollit të parametrave fizikë të kripës për sigurimin e cilësisë së këtij produkti.

- **Autoriteti Kontraktues:** Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës
- **SPV:** “Alb-Sale Vlorë” sh.p.k
- **Vlera e Investimit:** 1.4 miliardë Lek
- **Data e fillimit të kontratës:** 15 Qershor 2009
- **Kohëzgjatja e kontratës:** 35 vjet
- **Faza aktuale e projektit:** Operim

❖ Risqet

Në lidhje me risqet e kësaj kontrate koncesioni, risqet e parashikuara në kontratë dhe të alokuara tek koncesionari janë risku i ndërtimit, i operimit dhe performancës, risku i transferimit të asetëve dhe risku i disponueshmërisë. Ndërkohë risqet e alokuara autoritetit kontraktues janë risku material nga vendimet politike, risku i ndryshimeve ligjore dhe risku i lejeve dhe licencave, risku i inflacionit dhe risku i normës së interesit. Risqet e ndara mes dy palëve janë risku i rinegocimit, risku i ndërprerjes së kontratës dhe forca madhore.

Sektori i Bujqësisë¹⁸

114. Kontratë koncesioni/PPP “Për dhënien me koncesion të sipërfaqes deri në 1000 ha, në komunat Synej, Luz i Vogël, Kryevidh dhe Gosë, Kavajë për kultivimin e ullirit”

¹⁸ Informacion i hartuar në bazën e raportimeve të Autoritetit Kontraktues

Objekti i kësaj kontrate koncesioni është projektimi, ndërtimi, vënia në shfrytëzim, administrimi, mirëmbajtja e masivit të ullishtës, tregtimi i ullirit, si dhe transferimi i masivit të ullirit në përfundim të kontratës nga shoqëria koncesionare tek Autoriteti Kontraktues, konform kushteve dhe afateve të parashikuara në këtë Kontratë.

Referuar raportimeve dhe konfirmimit të Autoritetit Kontraktues, gjatë vitit 2022 kjo kontratë koncesioni ka qenë në fazë hibride, pasi shoqëria koncesionare ka mbjellë një pjesë

të sipërfaqes, ndërkohë pjesa tjetër e investimit është ngadalësuar për shkak të problematikave me pronësinë e tokës. Sipas raportimeve të Autoritetit Kontraktues, është kryer dorëzimi i sipërfaqes sipas parashikimeve të kontratës së nënshkruar midis palëve, por koncesionari pretendon se nuk i është dorëzuar sipërfaqja e parashikuar, duke e penguar kështu në ecurinë e projektit. Disa sipërfaqe janë në proces gjyqësor dhe pretendohen nga palë të treta, ndërkohë brenda një parcelë është dhënë një leje shfrytëzimi gurore, e cila ka shkaktuar probleme të mëdha në zhvillimin normal të aktivitetit, duke prishur strukturën e tokës.

Nga ana e shoqërisë koncesionare janë realizuar investime që konsistojnë në hapjen dhe mirëmbajtjen e rrugëve që të çojnë në parcelë dhe rrugëve të brendshme; janë kryer rrethimet e parcelave; janë kryer investime të rëndësishme në mbjelljen e parcelave me ullinj si dhe janë vendosur në pjesën më të madhe impianti i ujitjes me pika dhe me kanale kulluese. Për vitin 2022, sipas raportimit nga Autoriteti Kontraktues subjekti nuk ka kryer investime të reja, ka mbuluar shpenzimet operative për mirëmbajtjen e sipërfaqeve që tashmë janë të mbjella me ullinj dhe konservimin e investimit të kryer deri në atë moment, duke pretenduar për problematika të mbartura në vite, konkretisht pretendime të pronësisë nga persona të tretë për disa nga parcelat që shfrytëzohen nga Koncesionari si dhe dëmtimi i një pjese të sipërfaqes nga një leje shfrytëzimi duke prishur strukturën e tokës ku është kryer aktiviteti dhe duke e shndërruar në tokë të pa shfrytëzueshme dhe në shërbim të plantacionit me ullinj.

Gjatë vitit 2022 ky projekt është në fazë operimi, ka një progres të ngadaltë bazuar në objektivat e përcaktuara në kontratë. Shoqëria Koncesionare ka realizuar investime në makineri dhe investime në mbjellje parcelash me ullinj.

❖ Risqet

Në lidhje me risqet e kontratës, sipas raportimeve të Autoritetit Kontraktues, risku i ndërtimit, risku operacional, risku i përfundimit para kohe të kontratës i janë alokuar koncesionarit dhe gjithashtu janë vlerësuar me risk të lartë për të ndodhur. Gjithashtu risku ligjor (fakti që disa parcela janë në proces gjyqësor dhe pretendohen nga palë të treta, mund të vendosin në rrezik aktivitetin e koncesionit dhe arritjen e rezultateve të parashikuara). Një tjetër risk është risku klimatik, i cili ndikon procesin bujqësor dhe ecurinë e kontratës së koncesionit.

- **Autoriteti Kontraktues:** Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
- **SPV:** “Agrotal-1” sh.p.k
- **Vlera e Investimit:** 1.9 miliardë Lek
- **Data e fillimit të kontratës:** 07 Janar 2009
- **Kohëzgjatja e kontratës:** 99 vjet
- **Faza aktuale e projektit:** Operim dhe ndërtim
- **Forma:** Propozim i Pakërkuar

Sektori i Punëve të Brendshme¹⁹

115. Kontratë koncesioni/PPP “Për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe pasaportave biometrike”

Objekti i kësaj kontrate koncesioni është sigurimi i shërbimit të hartimit, përcaktimit, zhvillimit, zbatimit dhe operimit të Sistemit për furnizimin me Dokumenta identifikimi të shtetasve dhe/ose rezidentëve të Republikës së Shqipërisë.

Referuar raportimeve dhe konfirmimit të Autoritetit Kontraktues, gjatë vitit 2022 kjo kontratë koncesioni ka qenë në fazë operimi dhe sistemi i dokumentave të identitetit është

një sistem i sigurt dhe i teknologjisë së fundit në gjeneratën biometrike dhe bazohet në sistemin e automatizuar të identifikimit biometrik Morpho duke lënë pas sistemin e bazuar në procesin njerëzor manual dhe në letër. Gjithashtu, dokumentat biometrikë shqiptarë janë dokumenta të sigurt dhe në përputhje me standartet ICAO dhe të BE-së.

- **Autoriteti Kontraktues:** Ministria e Brendshme
- **SPV:** “Aleat” sh.p.k
- **Vlera e Investimit:** 25 milionë Euro
- **Data e fillimit të kontratës:** 15 Maj 2013
- **Kohëzgjatja e kontratës:** 10 vjet
- **Faza aktuale e projektit:** Përfunduar
- **Forma:** Propozim i Pakërkuar

Autoriteti ka raportuar që në periudhën e aplikimit masiv u instaluan mbi 505 poste aplikimi dhe shpërndarje në 356 zyra aplikimi online me qendrën e personalizimit në të gjithë Shqipërinë. Aplikimi për dokumente identiteti është online dhe ka burim të vetëm të të dhënave të shtetasve (perbërësve të gjendjes civile) RKGJC, i cili konsultohet nëpërmjet ndërfaqes së aplikimit nga sistemi i dokumenteve të identitetit. Autorizimi dhe certifikimi i aplikimeve për dokumente identiteti (letërnjoftimi dhe pasaportat biometrike) realizohet nga punonjesi i shërbimit të gjendjes civile dhe nga strukturat përkatëse të komisariateve të policisë. Infrastruktura e sistemit garanton identifikimin, regjistrimin, kontrollin (me bazën e të dhënave të Personave në kërkim, me databazat përkatëse të sistemit të dokumenteve të identitetit), prodhimin dhe lëshimin e sigurt dhe sipas standarteve të kërkuara të këtyre dokumenteve.

Në lidhje me treguesit e performancës sipas raportimit të Autoritetit Kontraktues, për gjithë vitin 2022 janë prodhuar dhe shpërndarë 548,348 Karta ID dhe 339,464 Pasaporta Biometrike.

❖ Risqet

Në lidhje me risqet e kontratës, sipas raportimeve të Autoritetit Kontraktues, risku i ndërtimit, risku operacional risku i përfundimit para kohe të kontratës, janë vlerësuar si risqe me probabilitet të ulët për tu materializuar ndërsa për riskun financiar AK është shprehur se ka probabilitet të ulët për t’u materializuar. Risku i veprimeve negative të qeverisë (MAGA) dhe risku i ndryshimit të ligjit, risku i rinegocimit dhe risqe të tjera janë vlerësuar si risqe të mesme për tu materializuar nga ana e Autoritetit Kontraktues. Risku i forcës madhore është vlerësuar i lartë dhe Autoriteti ka argumentuar që në marrëveshje me koncesionerin mund t’i rimbursojë kostot e Forcës Madhore Koncesionerit në monedhë, apo të kompensojë koncesionerin për të tilla kosto me anë të shtrirjes së përshtatshme të Periudhës së Koncesionit.

¹⁹ Informacion i hartuar në bazën e raportimeve të Autoritetit Kontraktues

Lista e Kontratave të Koncesionit për vitin 2022²⁰

²⁰ Burimi: ATRAKO: “Regjistri i Koncesioneve/PPP” http://atrako.gov.al/?page_id=112

Tabela e mëposhtme paraqet numrin e koncesioneve në total të miratuara deri në fund të vitit 2022, sipas Regjistrisë të Koncesioneve të disponueshme nga Agjencia e Trajtit të Koncesioneve.

❖ **Tabela 104: Kontrata të Koncesionit/PPP të nënshkruara deri në fund të vitit 2022.**

Objekti i Kontratës	Vlera e investimit Lekë
Per dhenien me koncesion/PPP të portit turistik dhe të shërbimeve Marina Limion	1,374,984,000
Për përmirësimin e infrastrukturës Arsimore në Bashkinë eTiranës për katër objektet arsimore në zonën Tirana 4	1,738,456,242
Per projektimin, ndertimin dhe mirembajtjen e segmentit rrugor Milot-Balldren	17,737,025,000
Per projektimin, ndertimin dhe mirembajtjen e rruges Porti i Jahteve-Bypass Orikum-Dukat (Ura e Shën Lizës)	5,817,298,748
Shërbimi i kontrollit ligjor të instrumentave mates, nepermjet instrumentave shperndares të karburantit dhe gazit të lengshem	70,000,000
Për rehabilitimin, operimin transferimin e Aeroportit të Kukësit	987,925,036
Për ofrimin e shërbimit laboratorik të spitaleve universitare, rajonale dhe atyre bashkiake të Sarandës dhe Lushnjës.	1,315,310,000
Për përmirësimin e infrastrukturës Arsimore në Bashkinë Tiranë	1,600,861,766
Për dhënien me koncesion të shërbimit të pastrimit, grumbullimit, transportimit dhe seleksionimit të mbetjeve urbane për Qytetin Kamëz.	1,350,000,000
Për ndertimin, operimin dhe transferimin e Hec Kukur	304,603,895
Për ndertimin, operimin dhe transferimin e Hidrocentralit Bushtrica 3	559,309,182
Për përmirësimin, ndertimin, operimin dhe mirëmbajtjen e Rrugës së Arbrit	26,504,000,000
Për ndërtimin e Hidrocentraleve mbi Lumin Shalë	11,239,204,263
Për ndertimin e Hidrocentralit Veleshicë	927,928,003
Për ndërtimin e Hidrocentralit Kalivaç	16,913,853,000
Për paketën e shërbimeve të kontrollit mjekësor bazë për grupmoshat 40-65 vjeç	172,020,000
Për dhënien me koncesion të disa shërbimeve detare	238,374,000
Per ndertim landfillit inceneratorit dhe rehabilitimin e venddepozimeve ekzistuese Tirane dhe prodhimin e energjise elektrike.	17,121,152,055
Ndërtimi, operimi dhe transferimi Hidrocentraleve mbi Lumin Devoll, Infrastruktura zëvendësuese	7,000,000,000
Projektimi, financimi ndertimin, operimi, mirembajtja dhe transferimi i Hidrocentralit ne Lumin Devoll	130,000,000,000
Ndertimin, operimin dhe transferimin e Hidrocentralit Stojan	124,333,623
Ndërtimin, operimin, transferimin e Hidrocentralit Guri i Bardhë	800,908,292
Për dhënien me koncesion të prodhimit të kripës Nartë, Vlorë	1,400,000,000
Për Dhënien me Koncesion të Rregjistrisë të Barreve Siguruese	35,691,880
Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Lunik	786,900,000
Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Bushtrica 1	506,147,190
Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve mbi lumin Shushicë	2,433,789,054

Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Grabovë 2	1,486,571,351
Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Shutri 1, Shutri 2	136,783,700
Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve të Lusës	621,368,362
Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Përroin Sheja e Librazhdit	492,775,800
Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Malla	176,321,017
Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Blaç	44,000,032
Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Malind	294,085,200
Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Selca 2, Mesmal	269,981,177
Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Batra 1, Batra 2, Batra 3	369,786,250
Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Zalli i Qarishtes	5,273,943,244
Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Truen	192,560,000
Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Gojan, Gjegjan, Peshqesh, Ura e Fanit, Fangu	16,322,955,740
Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Zall Xhuxhe 1, Zhall Xhuxhe 2	85,780,000
Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Sekë	1,177,887,502
Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve mbi lumin Gostimë, Egnatia Shushicë	7,806,058,026
Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Stavec	870,315,194
Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Rapun 1, Rapun 2	749,448,400
Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Darsi 1, Darsi 2, Darsi 3, Darsi 4	1,230,440,516
Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve ne lumin e Shalës	18,915,950,757
Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Valbona	274,205,000
Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve në Rrjedhën e lumit Shkumbin, Qukës	6,249,092,892
Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve mbi përroin Zalli i Lunikut Librazhd	1,702,149,000
Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Topçias	128,221,000
Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Gjoni, Blishta, Klosi, Domi, Luçi, Shoshaj, Zenishti, Burreli	4,069,596,314
Ndërtim, operim, transferim e 5 Hidrocentraleve në rrjedhën e lumit Shkumbin	847,000,000
Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve mbi lumin Valbonë rrethi Tropojë.	7,327,423,467
Për ndërtimin e administrimit e Impjantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier dhe prodhimin e energjisë	3,727,189,322
Për ndërtimin, operim dhe transferim të Hidrocentraleve Veleshica 1, 2, 3, 4, 5, 6 Sllove dhe Bjeshke	3,254,323,134
Për ndërtimin operimin dhe transferimin e Hidrocentralit Peshku	188,055,946
Ndërtim, shfrytëzim dhe transferim të Hidrocentraleve Lura 1, 2 dhe 3	1,300,177,500
Ndërtimin, operimin dhe transferimin e Hidrocentraleve Kaskada e Luses	743,776,400
Ndërtim, operim dhe transferim të Hidrocentraleve në Kaskadën e Osumit	32,377,517,340

Ndërtim, operim dhe transferim Hec Holta Kabash dhe Holta Porocan	500,000,000
Ndërtim, operim dhe transferim i Hidrocentralit Dragobia	2,404,858,492
Ndërtimin, operimin dhe transferimin e Hidrocentralit Begaj	2,794,366,000
Ndërtimin, pronësinë, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Hidrocentralit të ri në Ashta	19,520,000,000
Ndërtimi, përmirësimi, shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e Autostradës Milot-Morinë	5,348,534,084
Prodhimi dhe shpërndarja e kartave të identitetit dhe pasaportave elektronike.	-
Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Cangonj	62,650,250
Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Iballe 1, 2, Sapaç 1, 2, Berisha dhe Liqeni, Rrethi Pukë	1,572,169,360
Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Arrez 1, Arrez 2, Arrez 3 dhe Arrez 4	295,860,000
Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Kasollet e Selcës	526,318,254
Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Steblevë	159,680,320
Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Suha 2	360,000,000
Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Bënçë dhe Tepelenë	675,221,200
Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Meshanik dhe Guvë	216,152,500
Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Çaje, Reke, Livadhe, Shkinak, Lapaj 2, Bushtrica 1, Bushtrica 2 dhe Bushtrica 3	3,673,402,000
Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve në Pellgun Ujëmbledhës të Zallit të Bulqizes/Vajkal- Rrethi Bulqize	587,563,575
Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Myhejani 1, Myhejani 2, Myhejani 3	577,625,340
Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Backa 1, Backa 2, Backa A, Backa B, Backa C	1,156,808,769
Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Lefter 1, Lefter 2A, Lefter 2B, Lefter 3 (Zgjidhur me marrëveshjen me nr 2357 Rep nr 1173/3 Kol datë 06.11.2018)	208,659,212
Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Ballenjë	138,314,960
Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Kaçinar	315,219,168
Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Lumzi	1,725,593,333
Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Plepi, në Përroin e Plepit, Komuna Okshtun, Rrethi Diber	86,818,382
Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Vendresh, në Pellgun ujëmbledhës Përroi Vendreshes, Komuna Vendresh, Rrethi Skrapar	37,250,000
Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve mbi Lumin Gjader	1,592,690,975
Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Kaskada e Hec-eve të Hotolishtit	567,859,875
Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Dobrenje-Tomorrice, në Përroin e Hijes, Skrapar	106,780,000
Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Potam	291,900,000
Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Guri I Kuq 1/1 dhe Guri I Kuq 1/2	136,963,790
Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Denas	936,000,000
Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Vokopola 1, Vokopola 2 dhe Vokopola 3	497,257,690
Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Shengjon, Komuna Fan, Rrethi Mirditë	101,242,260

Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Skatinë	129,541,704
Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Shkopet 2 dhe Shkopet 3	2,273,383,994
Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Bregu i Madh	128,136,000
Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Gavran1 dhe Gavran	164,333,245
Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Bershi-Klos	250,548,894
Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Shengjun	349,864,502
Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Bigas dhe Veleshnje	42,420,000
Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Nishan	212,520,000
Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Quku 1 dhe Quku 2	150,894,676
Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Shutri	139,666,667
Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Vernik 1, Vernik 2, Vernik 3 dhe Vernik 4	971,365,040
Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Lajthia, Kolesjan, Domaj	123,761,020
Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Kryezi 3, Kryezi 4 dhe Kryezi 5	131,064,360
Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Shpella Poshtë II dhe Shpella Poshtë III	144,560,000
Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentralit Tuçep 2	166,000,000
Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentraleve mbi Lumin Curraj, Rrethi Tropojë	13,728,387,330
Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentralit Suha-1	3,181,563,000
Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentralit Spathare	80,070,750
Ndërtim, operim, transferim i hidrocentralit Labinot Fushë	347,706,122
Ndërtim, operim dhe transferim, i Hidrocentraleve, Prishta1, Prishta 2,	329,256,843
Ndërtim, operimin dhe transferimin e Hidrocentraleve në Pellgun Ujëmbledhës të Shmilit dhe Zallit të Gjurait, Rrethi Librazhd	1,165,964,018
Ndërtim, operimin dhe transferimin e Hidrocentralit Lingjaca	149,524,860
Ndërtim, operimin dhe transferimin e Hidrocentraleve Gjuraj, Kashec, Ragam dhe Lepurushe	780,000,000
Ndërtim, operimin dhe transferimin e Hidrocentraleve, Cemerica 1, Cemerica 2 dhe Cemerica 3	300,673,715
Ndërtim, operimin dhe transferimin e Hidrocentralit Egnatia	321,956,600
Ndërtim, operimin dhe transferimin e hidrocentraleve VRANISHT, STROPAN, GRAPSH-ZICISHT dhe HOCISHT	92,548,781
Ndërtim, operimin dhe transferimin e hidrocentralit VILIQ	199,260,305
Ndërtim, operimin dhe transferimin e hidrocentralit KALIVAR	465,326,140
Ndërtim, operimin dhe transferimin e hidrocentralit ARSTI	225,125,130
Ndërtim, operimin dhe transferimin e hidrocentralit QYTEZË	27,700,000
Ndërtim, operimin dhe transferimin e hidrocentraleve mbi Përroin Ujëmbledhës të Përroit të Zhejës	61,916,210
Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentraleve mbi Lumin SETA	1,400,805,550

Ndërtim, operim dhe transferim I hidrocentraleve FLETI 1, FLETI 2, FLETI A dhe FLETI B	815,963,996
Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentralit RUNJA	351,244,805
Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentraleve GERMANI 1, 2, 3, 4 dhe 5	348,238,001
Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentraleve PRELLE 1 dhe PRELLE 2	1,512,585,536
Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentralit LLËNGË	252,559,542
Ndërtim, operim dhe transferim e hidrocentraleve SHEBA 1, SHEBA 2, SHEBA 3 dhe SHEBA 4	416,000,000
Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentraleve të Lashkizës	322,691,040
Ndërtim, operim dhe transferimin e hidrocentraleve ZAJE, TUJAN, XHAFERAJ, KOLLOVOZ, NOVOSEJË, MËSHTEKËN	223,087,239
Ndërtimin, operimin dhe transferimin e hidrocentraleve RAPUN 3, RAPUN 3A dhe RAPUN 4	790,361,250
Rehabilitimin, operimin dhe transferimin e hidrocentralit DOMAJ, Has	12,369,610
Ndërtimin, operimin dhe transferimin e hidrocentraleve mbi Lumin Kardhiq	1,041,453,039
Ndërtimin, operimin dhe transferimin e hidrocentraleve TREBINJA 1, TREBINJA 2, POTGOZHAN, KALIVAÇ dhe DUNICE	175,585,602
Ndërtim, operim dhe transferimin e hidrocentralit ZEREC	120,311,959
Ndërtim, operim dhe transferim i hidrocentraleve ARRËZ, SHËNDELLI, SOTIRE, PODE, MESARE, URA, RAJAN 2, RADON, DEDOVE, PESHTAN, OSNATI DHE GRADISHT	837,404,386
Ndërtim, operim dhe transferim i hidrocentraleve KUKUR 1, 2, 3, 4 dhe 5	4,547,551,449
Ndërtimi operimi dhe transferimi i hidrocentraleve Sotirë, Sotirë 2	144,554,509
Ndërtimi operimi dhe transferimi i hidrocentraleve Gur Shpat1, Gur Shpat 2	176,738,773
Ndërtimi operimi dhe transferimi i hidrocentralit Mollaj	79,700,000
Ndërtimi operimi dhe transferimi i hidrocentralit Lapaj	1,453,500,000
Ndërtimi operimi mirëmbajtja dhe transferimi i hidrocentraleve të kaskadës së lumit Dardhë.	907,956,000
Ndërtimi operimi mirëmbajtja dhe transferimi i hidrocentralit Lena 1, Lena 2, Lena 2-A	311,332,059
Ndërtimi operimi mirëmbajtja dhe transferimi i hidrocentraleve Lenie, Shalës, Strelcë	354,282,240
Ndërtimi operimi mirëmbajtja dhe transferimi i hidrocentralit Picar 1	35,455,750
Ndërtimi operimi mirëmbajtja dhe transferimi i hidrocentralit Qafëzeze	51,955,070
Ndërtimi operimi mirëmbajtja dhe transferimi i hidrocentralit Verbë - Selcë.	285,214,050
Ndërtimi operimi mirëmbajtja dhe transferim të hidrocentraleve Murdhar 1 dhe Murdhar 2	501,411,750
"Dhënie me Koncesion/Partneritet Publik Privat të Shërbimit të Sistemit dhe Menaxhimit të Parkimit në Qytetin e Vlorës	-
Ndërtimi, Operimi, Transferim i parkimit nëntokësor në parkun "Rinia", Tiranë	1,937,932,800
Ndërtim, Operim, Transferim i hidrocentralit Poçem	14,134,724,113
Kontratë Koncesioni për kultivimin e ullirit deri në 1000 ha, Kavajë	1,906,500,000
Menaxhimi dhe zhvillimi teknologjik i prodhimit të fidanëve pyjor/arror në Fidanishten Shtetërore të Cërrikut, Elbasan	49,660,000

Ndërtimi dhe administrimi i impiantit të përpunimit të mbetjeve urbane të qarkut Elbasan	3,028,104,000
Shfrytëzimi i Burimit ujor "Sasaj, Bunec", Sarandë	503,712,646
Ndërtim, Shfrytëzim dhe Transferim në pronësi të shtetit, të Portit të Jahteve Shëngjin	730,338,000
Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Nishova 1, 2	986,526,398
Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Vlushë	1,718,835,000
Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Përroi i Trebishit, Bulqizë	209,336,441
Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Çekrezë 1, 2	123,858,465
Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Radovë	188,000,000
Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Hurdhasi 1, 2, 3	200,000,000
Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Stravaj	503,529,364
Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Shutinë	115,000,000
Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Kacni	133,121,000
Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Strelca 1, Strelca 2, Strelca 3	1,084,000,000
Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Progonat, Lekdush - Bënçë e Sipërme (Zgjidhur më 02.03.2018).	929,146,830
Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Peqin	521,573,382
Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Nicë	49,800,000
Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Vërtop	283,950,430
Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Shtika 1,2,3,4	87,570,000
Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Koxheraj	102,963,375
Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Perrollaj	51,434,808
Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Driza	151,000,000
Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Lumi Zalli i Okshtunit	4,443,351,400
Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Qarr Kaltanj	273,892,660
Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Lumi Treskës	656,545,309
Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Kozel, Helmes 1 dhe Helmes 2	108,000,000
Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Ujanik 2	134,550,000
Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Bisak	50,617,908
Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Bistrica 3 dhe 4	756,400,000
Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Lengarica 1 dhe 2	1,980,904,000
Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Gostivisht, Langarica3, Ura e Dashit	309,815,533
Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Ostren i Vogël	46,870,792
Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Shemri dhe Mguille	69,026,908

Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Kryezi dhe Kryezi i Epërm	50,419,481
Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Sllabinjë	1,290,117,487
Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Martanesh	857,861,985
Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Belesova 1 dhe 2	46,315,030
Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Borje, Oreshkë, Cernalevë, Cernalevë 1	830,097,322
Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit koka 1	392,862,289
Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Klos	96,422,100
Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Bishnica 1 dhe 2	250,000,000
Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Pobreg	995,034,550
Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Selishtë	120,000,000
Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Orgjost i Ri; Bele 1, 2; Topojan 1,2	3,565,744,707
Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Dobjot i Madh, Arrëz, Miras, Menkulas, Bracen, Kuç.	124,254,000
Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Liqenet, Maja e Madhe, Zanore, Dragostunjë, Frari, Hotolisht, Ura	424,080,723
Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Zerec 1,2	199,921,096
Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Gomsiqe 1,2,3,4 (Zgjidhur me marrëveshjen me nr 242 Rep, nr 1186/1 Kol datë 16.11.2018)	2,149,411,466
Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Thanë, Mollas	1,042,888,000
Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Kabash 1 dhe 2	671,000,000
Infrastruktura Hekurudhore Fier-Ballsh, Fier-Vlorë	2,431,918,164
Projektim, financim, rehabilitim, testim, shfrytëzim dhe mirëmbajtje të Qendrave të Kontrollit Teknik të mjeteve.	561,003,000
Menaxhimi, Operimi, Mirëmbajtja, Përmirësimi teknik dhe Adaptimi i terminalit të trageteve dhe krocerave Durrës.	581,387,190
Kryerja e shërbimit të rimorkimit të anijeve, Shërbimi i Transportit, Transportimi i Ekuipazheve të anijeve, Operacionet e ngarkim-shkarkimit.	1,200,000,000
Operimi, Ndërtimi, Mirëmbajtja, Përmirësimi Teknik dhe Adaptimi i Terminalit Lindor Durrës.	2,069,371,737
Ndërtimi, Shfrytëzimi dhe Transferimi të portit të tipit MBM, Porto Romano, Durrës	1,280,814,000
Financimi, Projektimi, Ndërtimi, Vënia në Punë, Administrimi, Mirëmbajtja dhe Transferimi i Hidrocentraleve "Shkallë", "Cerrujë", "Plesha", "Bejni1", "Bejni2", "Klos".	1,465,039,743
Rehabilitimi, Operimi dhe Transferimi i Hidrocentralit "Labinot-Mal"	12,500,000
Ndërtimi, operimi dhe transferimi i hidrocentralit Fterre dhe Fterre 1.	650,565,750
Ndërtimi, operimi dhe transferimi i hidrocentralit Tervol	325,800,167
Ndërtimi, operimi dhe transferimi i hidrocentralit Faqekuq 1 dhe 2	587,975,273
Ndërtimi, operimi dhe transferimi i hidrocentralit Dishnicë	15,300,000
Ndërtimi, operimi dhe transferimi i hidrocentralit Lubonjë	39,000,000
Ndërtimi, operimi dhe transferimi i hidrocentralit Çarshovë	83,500,000

Shërbimi i Hemodializës	1,177,420,000
Shërbimi i markimit dhe monitorimit të karburanteve	444,939,000
Financimi, ngritja dhe operimi i shërbimit të skanimit të konteinerve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë.	2,836,560,000
Krijimi dhe funksionimi i sistemit të kontrollit të pullave fiskale.	1,263,507,600
Ndërtimi, Operimi dhe Transferimi i Aeroportit "Nënë Tereza"	9,114,560,000
Ndërtimi, shfrytëzimi i portit të jahteve në qytetin e Durrësit. (BOT)	1,356,144,750
Ndërtimi i portit të jahteve në Kalanë e Turrës, Komuna Synej, Kavajë.	4,450,000,000
Menaxhimi, operimi, mirembajtja dhe pëmirësimi teknik i terminalit të konteinerve në portin e Durrësit	3,191,825,000
Ofrimi i setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale, material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimi i mbetjeve biologjike dhe dezinfektimi i sallave kirurgjikale.	1,503,282,620
Dhënia me Koncesion/PPP të një porti turistik në qytetin e Vlorës "Marina Vlorë"	2,822,865,665
Për projektimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Aeroportit ndërkombetar të Vlorës	1,374,984,000

Aneks 1 - Koncepte dhe Kuadri Ligjor

Koncepti i Koncesioneve dhe Partneritetit Publik Privat

Koncesioni është një formë partneriteti midis palës publike dhe asaj private në ofrimin e punëve dhe shërbimeve publike.

Sipas Ligjit nr.125/2013 “Për koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat” i ndryshuar, përkufizimi i koncesioneve jepet në këtë mënyrë:

“Koncesioni është një marrëveshje me interes financiar, e lidhur me shkrim ndërmjet autoritetit kontraktues dhe një ose më shumë operatorëve ekonomikë, objekti i së cilës është kryerja e punimeve, ku shpërblimi për punimet/shërbimet që duhet të kryhen përbëhet nga e drejta për të shfrytëzuar veprat/shërbimet që janë objekt i kontratës ose nga kjo e drejtë së bashku me pagesën”,

ndërsa Partneriteti Publik Privat përcaktohet si:

“...Kontratë e punëve publike apo kontratë e shërbimit publik, që plotëson kushtet, të cilat e përcaktojnë atë si një partneritet publik privat, sikurse është rregulluar në këtë ligj dhe që nënshkruhet ndërmjet autoritetit kontraktues në njërën anë dhe operatorit ekonomik të zgjedhur si ofertuesi më i suksesshëm.”

Për vlerësimin sistematik të implikimeve të mundshme makrofikale nga projektet me koncesion/PPP, është zhvilluar modeli PFRAM nga FMN dhe Grupi i Bankës Botërore. Ky model gjithashtu siguron një kornizë për identifikimin e risqeve fiskale të lidhura me një projekt PPP, vlerësimin e tyre dhe diskutimin e masave përkatëse zbutëse. Më poshtë është paraqitur një përmbledhje e risqeve kryesore që përfshihen tek matrica e risqeve sipas modelit PFRAM, si dhe merren parasysh në vlerësimin e analizës së risqeve për projektet që paraqiten për miratim në Ministrinë e Financave.

Risqet Kryesore të Kontratave Koncesionare/PPP

Risku i projektimit dhe ndërtimit: Lidhet me situatat ku ndërtimi zgjat më shumë ose kushton më shumë se sa pritej, ose që cilësia e projektimit apo e ndërtimit nënkupton se aseti nuk është i mjaftueshëm për të përmbushur kërkesat e projektit

Risku i lejeve dhe licencave: Kostot që mund të vijnë nga vonesat e marrjes apo dhënies së lejeve që lidhen me projektimin ndërtimin, operimin apo mirëmbajtjen e projektit.

Risku i kërkesës: Ky risk lidhet me situatat ku përdorimi i objektit/shërbimit është i ndryshëm nga sa pritej ose të ardhurat nuk janë aq sa priten.

Risku i operimit dhe performancës: Mosofrimi i punëve, shërbimeve apo veprave të koncesionit/PPP me cilësi, efikasitet dhe efikasitet.

Risku Financiar: Risk që lidhet me luhatjet në normën e interesit, normën e kursit të këmbimit, normën e inflacionit dhe kushtet e tjera financiare

Forca Madhore: Risqet që lidhen me ngjarjet përtej kontrollit të palëve në kontratë, të tilla si: fatkeqësitë natyrore, luftëra ose trazira civile, që ndikojnë mbi projektin.

Risku material nga vendimet politike: Kanë të bëjnë me riskun që lind si pasojë e vendimeve të dobëta politike të bërjes së procesit, stabiliteti qeveritar, kundërshtimi politik dhe shpronësimi.

Risku i ndryshimeve ligjore: Risku që një ndryshim në ligjin ose në rregullat e përgjithshme ndikon negativisht mbi projektin, të tilla si: ndryshimet në tatimet e përgjithshme të korporatave ose në rregullat që rregullojnë këmbimin e monedhës, ose riatdhesimin e fitimeve;

Risku i rinegocimit: Risk që lidhet me ndryshimet në kontratë që implikojnë kosto fiskale në buxhetin e shtetit.

Risku transferimit të aseteve: Risqet që lidhen me pronësinë e aseteve, duke përfshirë riskun që teknologjia vjetërohet ose, që vlera e aseteve në fund të kontratës është e ndryshme nga sa pritej si dhe riskun e transferimit të ndonjë detyrimi të marrë përsipër mbi asetin gjatë kohëzgjatjes së kontratës.

Risku i ndërprerjes së kontratës: Risk që rrjedh nga ndërprerja e kontratës dhe implikon kosto fiskale për buxhetin e shtetit.

Në këtë raport synuar të jepet një pamje e përgjithshme e situatës aktuale të kontratave koncesionare/PPP aktive në vend, ku janë evidentuar të dhënat kryesore në lidhje me projektin, risqet që implikojnë, materializimin e tyre dhe impaktin që kanë pasur.

Kuadri Ligjor i Koncesioneve/PPP në Republikën e Shqipërisë

Legjislacioni shqiptar fillimisht i ka trajtuar koncesionet me anë të ligjit nr. 7973, datë 26.7.1995 “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë”, i cili më pas është zëvendësuar nga Ligji Nr. 9663, datë 18.12.2006, “Për Koncesionet”. Përgjatë viteve të fundit, bazuar edhe në praktikat e biznesit si edhe në përshtatje të legjislacionit dhe qasjes ndërkombëtare mbi koncesionet dhe partneritetin publik privat është miratuar një koncept më i gjerë i koncesioneve duke futur edhe përkufizimin e partneritetit publik privat, i përcaktuar tashmë edhe në dispozitat ligjore të ligjit aktual që rregullon këtë fushë, përkatësisht Ligji Nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”,²¹ i ndryshuar.

Veç ndryshimeve të mëparshme, ky ligj ka pësuar disa ndryshime nëpërmjet Ligjit Nr.50 datë 18.07.2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat” i botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 126 datë 13.09.2019.

Kuadri ligjor aktual i koncesioneve dhe PPP mbështetet kryesisht në legjislacionin e mëposhtëm:

- Ligji nr. 50/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin 125/013: Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”, i ndryshuar.
- VKM nr. 575, datë 10.07.2013 “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me Koncesion/Partneritet Publik Privat”, i ndryshuar.

²¹ Burimi: ATRAKO, “Manuali për Përdoruesit” URL: http://www.atrako.gov.al/?page_id=973.